



STUDIMET PASDIPLOMIKE – CIKLI I DYTË

TEZA:

**“NIVELI I BONITETIT TË SUBJEKTEVE EKONOMIKE NË
REPUBLIKËN E MAQEDONISË, ME THEKS TE VEÇANTË NË
REGJIONIN E TETOVES”**

KANDIDATI:
Fikret Selmani

MENTOR:
Assoc. Prof. Dr. Jeton Mazllami

Shtator, 2019

DEKLARATË

Unë, Fikret Selmani student në studimet postdiplomike në Fakultetin e Biznesit dhe të Ekonomisë në Universitetin e Evropës Juglindore –Tetovë, deklaroj se ky punim masteri është punë hulumtuese e imja dhe se nuk është publikuar më parë nga autorë të tjerë. Çdo material që kam përdorur është deklaruar në tekst me referencë përkatëse dhe bibliografia përmban të gjithë literaturën që kam përdorur gjatë gjithë punës sime hulumtuese.

Jam i vetëdijshme se çdo shkelje e rregullave të caktuara do të rezultojë me anulimin e këtij studimi empirik.

Nënshkrimi

Lektoroi:

Doc.dr.Luljeta Adili-Çeliku

MIRËNJOHJE

Për të arritur një punë të suksesshme kërkohet kohë dhe mund i madh, ndërkaq përkushtimi dhe këmbëngulësia në hulumtimin shkencor më kanë mundësuar që t'i realizoj objektivat e mia.

Falënderimi i posaçëm shkon për mentorin tim *Assoc.Prof. Dr. Jeton Mazllami* për përkushtimin dhe gatishmërinë për të më ndihmuar në çdo kohë, për këshillat dhe komentet, të cilat më ndihmuan jashtëzakonisht shumë në përfundimin e tezës së masterit. Gjithashtu një falënderim shkon edhe për anëtarët e komisionit *Doc. Prof.Dr. Fitim Deari* dhe *Assoc.Prof.Dr. Sadri Alija*.

Mirënjohjet më të thella shkojnë edhe për *familjen time* që në çdo kohë më ka dhënë dashurinë e pakufishme, mbështetjen morale si dhe atë financiare. Ky punim u dedikohet prindërve të mi, pa të cilët nuk do të kisha arritur aty ku jam sot.

Një falënderim shkon gjithashtu edhe për *miqtë dhe kolegët* e mi për mbështetjen e pakufishme që ma kanë dhënë gjatë gjithë kësaj kohe.

“NIVELI I BONITETIT TË SUBJEKTEVE EKONOMIKE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË, ME THEKS TE VEÇANTË NË REGJIONIN E TETOVËS”

Abstrakt

Zhvillimi real i subjekteve afariste paraqet një parakusht për një ekonomi të shëndoshë dhe me perspektivë zhvillimore. Pasqyrat financiare janë treguesi bazë i të dhënave financiaro ekonomike të subjekteve afariste që mundëson vlerësimin e gjendjes ekonomiko financiare të një subjekti afarist për një periudhë të caktuar kohore. Analiza e pasqyrave financiare paraqet procesin më të rëndësishëm të procedimit të të dhënave kontabël drejt krijimit të informatave relevante në procesin e vendimmarrjeve të rëndësishme afariste. Procesi i analizës financiare është dizajnuar për të ndihmuar ndërmarrësit, investorët dhe huadhënësit që të kuptojnë të tashmen dhe të projektojnë të ardhmen me qëllim të rritjes dhe zhvillimit të afarizmit të tyre.

Qëllimi i punimit të masterit është të ofrojë shpjegimin dhe zbatueshmërinë e treguesve financiarë të njohur si “Bonitet” në analizën e veprimtarive afariste si: *treguesit e stabilitetit financiar, treguesit e likuiditetit financiar dhe treguesit e suksesit afarist në rajonin e Pollogut*. Ndërkaq kjo analizë në vend njihet si *“Informacioni rreth gjendjes ekonomiko financiare të subjektit afarist”*.

Përlllogaritjet dhe analiza financiare e subjekteve është bërë duke u bazuar nga llogaritë vjetore të një mostre përfaqësuese të përzgjedhur nga subjektet afariste të regjionit të Tetovës, si dhe duke përdorur literaturë adekuate, në sajë të të cilave do të bëjmë interpretimin e duhur të treguesve të fituar.

Qëllimi i punimit është të analizojë nivelin e bonitetit të subjekteve afariste sipas madhësisë dhe të konstatojë efektshmërinë e vendimmarrjeve ekonomiko financiare.

Fjalët kyçe: *analiza financiare, pasqyrat financiare, rentabiliteti, likuiditeti, boniteti, subjektet ekonomike, etj.*

“НИВОТО НА БОНИТЕТОТ НА ДЕЛОВНИТЕ СУБЈЕКТИ ВО РЕПУБЛИКА МАКЕДОНИЈА, СО ПОСЕБЕН ОСВРТ НА ТЕТОВСКИОТ РЕГИОН”

Абстракт

Вистинскиот развој на деловните субјекти е предуслов за здрава економија ориентирана кон раст. Финансиските извештаи се основниот показател за финансиските и економските податоци на деловните субјекти што овозможува проценка на економската и финансиската состојба на деловниот субјект за одреден временски период. Анализата на финансиските извештаи е најважниот процес на обработка на сметководствените податоци за создавање релевантни информации во процесот на донесување на значајни деловни одлуки. Процесот на финансиска анализа е дизајниран да им помогне на претприемачите, инвеститорите и работодавателите да ја разберат сегашноста и да планираат за иднината со цел да со цел да се зголеми и развива нивниот бизнис.

Целта на магистерскиот труд е да дадам објаснување и применливост на финансиските индикатори познати како „Бонитет“ во анализата на деловните активности, исто така: индикатори за финансиска стабилност, индикатори за финансиска ликвидност и индикатори за деловна успешност во полошкиот регион. Инаку, оваа анализа е позната во земјата како „Информации за економската и финансиската состојба на деловниот субјект“.

Пресметките и финансиската анализа на субјектите се извршени врз основа на годишните сметки на избраниот репрезентативен примерок на деловните субјекти од Тетовскиот регион и со употреба на соодветна литература правилно ќе ги толкуваме добиените показатели.

Целта на овој труд е да се анализира нивото на профитабилноста на деловните субјекти според големината и да се утврди ефикасноста на економското и финансиското донесување одлуки.

Клучни зборови: финансиска анализа, финансиски извештаи, профитабилност, ликвидност, бонуси, економски субјекти, итн.

“THE LEVEL OF THE ECONOMIC AND FINANCIAL STANDING OF THE ECONOMICS SUBJECTS IN A REPUBLIC OF MACEDONIA, WITH A SPECIAL EMPHASIS OF TETOVA REGION”

Abstract

The real development of business entities is a prerequisite for a healthy economy with a development perspective. The financial statements are the basic indicator of the financial and economic data of the business entities that enables the assessment of the economic and financial statement of a business entity for a certain period of time. The analysis of financial statements represents the most important process of processing accounting data to create relevant information in the process of significant making business decision. The financial analysis process is designed to help entrepreneurs, investors, and lenders to understand the present and plan for the future in order to grow and develop their business.

The purpose of the master thesis is to provide you with an explanation and applicability of the financial indicators known as "Boniti" in the analysis of business activities as well: financial stability indicators, financial liquidity indicators and business success indicators in the pollog region. Otherwise in the country this analysis is known as "Information about the economic and financial statement of the business entity".

The accounting and financial analysis of the entities were done based on the annual **(calculations)** of a selected representative sample of the business entities of the Tetovo region and by using adequate literature we will properly interpret the obtained indicators.

The purpose of this paper is to analyze the level of business entities profitability by size and to ascertain the effectiveness of economic and financial making-decision.

Keywords: financial analysis, financial statements, profitability, liquidity, bonuses, economic entities, etc.

Lista e figurave dhe grafikëve

Tabela 1. Klasifikimi i subjekteve të UE-së	28
Tabela 2. Kategoritë e subjekteve ekonomike.....	30
Tabela 3. Analiza e subjekteve ekonomike sipas madhësisë në RMV (2011-2018)	30
Tabela 4. Analiza e subjekteve ekonomike sipas veprimtarive ekonomike në RMV (2011-2018)	32
Tabela 5. Analiza e subjekteve ekonomike sipas regjioneve ne RMV (2011-2018).....	34
Tabela 6. Analiza e subjekteve ekonomike në regjionin e Pollogut, (2011-2018).....	35
Tabela 7. Pasqyrat financiare që duhet dërguar në Regjistrin Qendror të Maqedonisë së Veriut	43
Tabela 8. TREGUESIT E STABILITETIT FINANCIAR - (A/B)	65
Tabela 9. TREGUESIT E LIKUIDITETIT FINANCIAR - (A/B).....	65
Tabela 10. TREGUESIT E SUKSESIT TË SUBJEKTIT	66
Tabela 11. Struktura e SHT sipas madhësisë, në Tetovë dhe komunat e saj rural, 2016-2017.....	67
Tabela 12 Subjektet ekonomike të analizuara në komunën e Tetovës dhe komunat rurale	68
Tabela 13. Boniteti i subjekteve prodhuese me fitim për vitin 2017 dhe 2016.....	71
Tabela 14. Boniteti i subjekteve shërbyese me fitim për vitin 2017 dhe 2016	73
Tabela 15. Boniteti i subjekteve shërbyese me humbje për vitin 2017 dhe 2016.....	76
Tabela 16. Boniteti i subjekteve tregtare me fitim për vitin 2017 dhe 2016.....	79
Tabela 17. Boniteti i subjekteve tregtare me humbje për vitin 2017 dhe 2016	82
Tabela 18. Boniteti i subjekteve ekonomike mikro	83
Tabela 19. Boniteti i subjekteve ekonomike të vogla	84
Tabela 20. Boniteti i subjekteve ekonomike të mesme.....	85
Grafiku 1. Subjektet prodhuese me fitim69	
Grafiku 2. Treguesit e stabilitetit financiar te subjektet prodhuese me fitim	69
Grafiku 3. Treguesit e likuiditetit financiar te subjektet prodhuese me fitim	70
Grafiku 4. Treguesit e suksesit afarist te subjektet prodhuese me fitim	70
Grafiku 5. Subjektet shërbyese me fitim	71
Grafiku 6. Treguesit e stabilitetit financiar te subjektet shërbyese me fitim	72
Grafiku 7. Treguesit e likuiditetit financiar te subjektet shërbyese me fitim	72
Grafiku 8. Treguesit e suksesit afarist te subjektet shërbyese me fitim.....	72
Grafiku 9. Subjektet shërbyese me humbje.....	74
Grafiku 10. Treguesit e stabilitetit financiar te subjektet shërbyese me humbje	74
Grafiku 11. Treguesit e likuiditetit financiar te subjektet shërbyese me humbje	75
Grafiku 12. Treguesit e suksesit afarist te subjektet shërbyese me humbje	75
Grafiku 13. Subjektet tregtare me fitim.....	76
Grafiku 14. Treguesit e stabilitetit financiar te subjektet tregtare me fitim	77
Grafiku 15. Treguesit e likuiditetit financiar te subjektet tregtare me fitim	78
Grafiku 16. Treguesit e suksesit afarist te subjektet tregtare me fitim	78
Grafiku 17. Subjektet tregtare me humbje.....	79
Grafiku 18. Treguesit e stabilitetit financiar te subjektet tregtare me humbje.....	80
Grafiku 19. Treguesit e likuiditetit financiar te subjektet tregtare me humbje.....	81
Grafiku 20. Treguesit e suksesit afarist te subjektet tregtare me humbje	81

PËRMBAJTJA:

Hyrje.....	9
1.Përkufizimi dhe llojet e subjekteve ekonomike	15
1.1 Aspekte teorike për subjektet ekonomike.....	15
1.2 Llojet e subjekteve ekonomike sipas ligjit të SHT-RMV	21
1.3 Llojet e subjekteve ekonomike në UE.....	27
2. Struktura dhe trendi i subjekteve ekonomike sipas madhësisë dhe veprimtarive ekonomike ne RMV	29
2.1 Analiza e subjekteve ekonomike sipas madhësisë në RMV për periudhën kohore 2011-2018	29
2.2 Analiza e subjekteve ekonomike sipas sektorëve të veprimtarive ekonomike në RMV për periudhën kohore 2011-2018	32
2.3 Analiza e subjekteve ekonomike sipas regjioneve ne RMV me theks të veçantë për regjionin e Pollogut.	34
2.3.1Analiza e subjekteve ekonomike në regjionin e Pollogut.	35
3. Raportet Financiare.....	36
3.1 Raportet financiare te tregtarët individualë.....	40
3.2 Raportet financiare te shoqëritë tregtare.....	41
3.3 Raportet financiare te shoqëritë aksionare	42
3.4 Llogaria vjetore e shoqërive tregtare në RMV	43
4. Përcaktimi i gjendjes ekonomike financiare të shoqërive tregtare në regjionin e Tetovës	47
4.1.1 Treguesit e Likuiditetit	49
4.1.2 Raportet e përdorimit të aktiveve	52
4.1.3 Raportet e aftësive paguese (solventiteti).....	54
4.1.4 Treguesit e Rentabilitetit ROI.....	55
4.1.5 Raportet e tregut	57
4.2 Kuptimi dhe përkufizimi i nocionit të bonitetit.....	59
4.2 Metodologjia e përlogaritjes së BONITETIT – gjendja ekonomike financiare e SHT sipas Regjistris Qendror të RMV.....	64
4.3 Përshkrimi i mostrës së zgjedhur për komunën e Tetovës me komunat rurale.....	66
Konkluzionet dhe rekomandimet si të permiresohet gjendja	82

NIVELI I BONITETIT TË SUBJEKTEVE EKONOMIKE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË, ME THEKS TE VEÇANTË NË REGJIONIN E TETOVËS

Hyrje

Teza e këtij punimi të magjistraturës do të ndihmojë menaxherët që në kohë të marrin informacion për gjendjen dhe për prirjet e subjektit ekonomik, në mënyrë që të reagohet sa më shpejt të jetë e mundur, të parandalohet ndodhja e të papriturave si dhe të projektohet e ardhmja. Realizimi i funksioneve themelore financiare në një kompani, siç janë alokimi i fondeve për qëllime individuale, arritja e kombinimit optimal të burimeve për financimin e aktiviteteve individuale dhe arritja e shpërndarjes efikase të rezultatit financiar në përputhje me qëllimet e përcaktuara të operacionit, bazohet kryesisht në të dhënat e pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare janë burimi më i plotë i informacionit të biznesit që është në funksion të ofrimit të mbështetjes për menaxherët, aksionarët, kreditorët, punonjësit, autoritetet tatimore, organet rregullatore, kompanitë konkurruese, etj. Duke pasur parasysh se ka shumë përdorues të pasqyrave financiare, paraqitet nevoja për të strukturuar dhe përshtatur pasqyrat financiare me nevojat, në varësi të asaj nëse ato do t'u dedikohen përdoruesve të jashtëm apo atyre të brendshëm. Në të vërtetë, pasqyrat financiare tregojnë vlera monetare që paraqesin një burim të nevojshëm kuantitativ për të bërë analiza konkrete. Në mënyrë që ky informacion të jetë i dobishëm, është e nevojshme të krijohen marrëdhëniet e duhura midis pozicioneve të caktuara të bilancit. E gjithë kjo e imponon nevojën për të aplikuar metodën e analizës financiare në formimin e strukturës optimale financiare.

Analiza financiare është një proces për përcaktimin dhe njohjen e raporteve, treguesve financiarë, kurse interpretimi i tyre do të kontribuojë në vlerësimin e operacioneve aktuale, identifikimin e problemeve, fushave të mundësive potenciale, zhvillimin e buxheteve dhe zbatimin e strategjive të ardhshme që çojnë në përfitimin, aftësinë e pagesës dhe likuiditetin e subjekteve. Analiza financiare nënkuptohet edhe si një ekzaminim i hollësishëm i gjendjes

financiare dhe ekonomike dhe i rezultateve të operacioneve të një subjekti afarist. Ajo kryhet duke u bazuar në pasqyrat financiare të subjekti të biznesit: *bilanci i gjendjes, pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve, pasqyra e rrjedhës së parasë dhe pasqyra e ndryshimeve në kapital, bilancet tatimore, etj.*

Qëllimi i analizës së pasqyrave financiare është të ofrojë informacion që lidhet me gjendjen e stabilitetit financiar të njësisë ekonomike, likuiditetin, aftësitë arkëtuese-të pagesës dhe kapacitetin e tij të fitimit. Informacioni i marrë nga analiza financiare është pika fillestare për ndërmarrjen e aktiviteteve që synojnë përmirësimin e aftësisë paguese, si dhe trendin e rritjes dhe zhvillimit në biznesin e subjektit ekonomik. Domethënë, analiza financiare duhet të mundësojë vlerësimin përkatës të gjendjes financiare të subjekteve ekonomike, të identifikojë nevojën për zgjerimin e aktiviteteve afariste, si dhe nevojën për të marrë ose jo burime shtesë të financimit.

Qëllimet e hulumtimit

Qëllimi i studimit i kësaj teze të magjistraturës është përdorimi efikas i metodave bashkëkohore për analizën e pasqyrave financiare dhe të menaxhimit si mjet për marrjen e vendimeve afatshkurtra dhe vendimeve afatgjata (sugjerime për përmirësimin e gjendjes së subjekteve). Gjithmonë duhet pasur parasysh se vendimet strategjike merren nga analizat e bëra me të dhëna kualitative .

Në këtë tezë magjistrature objekt studimi do jetë implementimi i tërësishëm i metodave bashkëkohore për analizën e pasqyrave financiare të subjekteve ekonomike në Republikën e Maqedonisë. Gjithashtu analiza do t'i inkorporojë treguesit tradicionalë vendor të ashtuquajtur "BONITET" ose gjendje ekonomiko financiare e subjekteve ekonomike mikro, të vogla, të mesme dhe të mëdha, me një theks të veçantë në regjionin e Tetovës . Siç thamë më sipër, qëllimi kryesor i hulumtimit në këtë material është të kuptohet roli dhe rëndësia e këtyre treguesve për të identifikuar anët e forta/dobëta të subjekteve afariste me qëllim të menaxhimit të mirë me to.

Në këtë punim do të analizohen pasqyrat financiare të subjekteve afariste për marrjen e vendimeve përkatëse, financiare dhe investuese që çojnë në një rritje të vlerës së kapitalit, që është qëllimi kryesor i funksionimit të secilit subjekt ekonomik.

Analiza e treguesve financiarë përfshin :

1. Raportet e likuiditetit
2. Raportet e aktivitetit
3. Raportet e fitimit
4. Treguesit e strukturës financiare
5. Treguesit e performancës ose efikasiteti,
6. Treguesit e rentabilitetit ROI, ROA

Një subjekt ekonomik për të marrë informacion mbi gjendjen ekonomike dhe financiare duhet të paraqesë një kërkesë në Regjistrin Qendror të Maqedonisë së Veriut. Personat përgjegjës në Regjistrin Qendror, duke përdorur të dhënat nga llogaritë përfundimtare të çdo subjekti ekonomik për çdo vit, përgatisin raportin tradicional të ashtuquajtur “BONITET”.

Ky punim ka për synim të analizojë efektet financiare të subjekteve, efektshmërinë e vendimmarrjes dhe ndikimin e vendimeve në anën financiare.

Hipotezat

Në bazë të qëllimeve të hulumtimit, në këtë punim do të shtjellohen hipotezat e mëposhtme:

H₀: Niveli i Bonitetit i mikro subjekteve ekonomike është pozitiv!

H₀: Trendi i nivelit i Bonitetit të mikro subjekteve ekonomike është rritës!

H₀: Niveli i Bonitetit i subjekteve të vogla ekonomike është pozitiv!

H₀: Trendi i nivelit i Bonitetit të subjekteve të vogla ekonomike është rritës!

H_0 : Niveli i Bonitetit i subjekteve të mesme ekonomike është më pozitiv se tek ato të voglat!

H_0 : Trendi i nivelit i Bonitetit të subjekteve të mesme ekonomike është rritës!

Metodologjia e hulumtimit

Në këtë hulumtim do të përdoren te dhëna nga librat e botuar, gazeta të botuara, revista ndërkombëtare, artikuj të ndryshëm relevant, hulumtime etj.

Në ditët e sotme analiza e raporteve financiare është njëra nga disiplinat më të njohura dhe më frytdhënëse në sferën financiare. Në këtë sferë do të shfrytëzohen metoda të ndryshme të analizës së raporteve financiare, do të përdoren edhe teknika të përgjithshme dhe të veçanta shkencore, me ndihmën e të cilave do të arrihet deri në konkluzë dhe rekomandime adekuate dedikuar sektorit real në regjionin e Tetovës.

Nga gama metodologjike, në punimin e tezës së magjistraturës do të përdoren metodat e mëposhtme:

- Metoda e intervistës së drejtpërdrejt me drejtorët e subjekteve në regjionin e Tetovës.
- Metoda e analizës, që do të bazohet në pasqyrat financiare dhe dokumentet e tjera financiare dhe menaxheriale dhe dokumente të tjera të rëndësishme që do shfrytëzohen për të qenë sa më efikas në vërtetimin e hipotezave të parashtruara.
- Nga metodat e përgjithshme shkencore do të përdoret metoda statistikore, ku në mënyrë kuantitative do të jepen tabela dhe grafikë me të dhëna për gjendjen aktuale dhe gjendjen në 3 vitet e fundit të subjekteve.
- Po ashtu do të përdoret edhe metoda komparative (krahasuese).

Si metoda të veçanta shkencore do të përdoren:

- *Metoda kualitative dhe kuantitative*
- *Metoda e analizës dinamike dhe strukturore*
- *Analiza e trendit*
- *Metodat fundamentale dhe empirike për studim*

- *Metoda e pikës kritike të rentabilitetit dhe metoda të tjera kërkuese shkencore*

Rëndësia e punimit

Sektori real si një promotor i zhvillimit të ekonomisë në ekonominë e Maqedonisë së Veriut si një vend në tranzicion të stërzgjatur, nga fillimi e gjer më tani është ballafaquar me probleme të ndryshme financiare, menaxheriale dhe probleme sistemore juridike. Rëndësia e këtij punim qëndron në identifikimin e gjendjes ekonomike financiare të subjekteve ekonomike ndër vite duke i identifikuar problemet të cilat ndikojnë në gjendjen financiare të kompanisë.

Punimi i magistraturës do zhvillojë një aplikacion në MS Excel për përlogaritjen e treguesve të BONITETIT në RMV. Përfitimet e pritshme nga zbatimi i këtij aplikacioni do të jenë:

- ✓ *Llogaritja në kohë dhe e saktë e treguesve për përcaktimin e Bonitetit të subjekteve ekonomike;*
- ✓ *Krijimi i shpejtë dhe automatik i një raporti mbi gjendjen ekonomike dhe financiare të subjektit ekonomik;*
- ✓ *Parashikimi i operacioneve për një periudhë të ardhshme të subjektit ekonomik;*
- ✓ *Vlerësimi a është sistemi kosto-efektiv.*

Përfundim

Në bazë të përlogaritjeve të analizuara sipas llogarive vjetore të një mostre të caktuar në regjionin e Tetovës do të arrijmë të sjellim konkluzione përkatëse të gjendjes ekonomike financiare të subjekteve ekonomike (*mikro, të vogla, të mesme dhe të mëdha*) si një parakusht të një ambienti afarist të volitshëm në vend.

Rrethanat e sotme afariste kërkojnë nga subjektet ekonomike rritjen e nivelit të treguesve financiar për të rritur shkallën e besueshmërisë dhe për të reduktuar nivelin e rrezikut dhe më pas të krijojnë raporte debitore kreditore.

Në fund të punimit do të jepen konstatime rreth gjendjes ekonomike financiare të subjekteve ekonomike në regjionin e Tetovës duke u dhënë përgjigje hipotezave të parashtruara.

1.Përkufizimi dhe llojet e subjekteve ekonomike

1.1 Aspekte teorike për subjektet ekonomike

Duhet pasur parasysh se ekzistojnë teori të shumta që ilustrojnë pamjen, rolin dhe përbërjen organizative të subjekteve ekonomike dhe për këtë arsye ekzistojnë dilema të shumta në lidhje me madhësinë optimale të një subjekti ekonomik, duke pasur parasysh faktin se madhësia e subjektit ekonomik është me interes dhe se subjektet ekonomike me shqetësim të vazhdueshëm trajtohen si një entitet i veçantë shoqëror që kontribuon ndjeshëm në funksionimin e çdo ekonomie kombëtare. Prandaj, shumë vende kanë miratuar shumë ligje, institucione dhe instrumente të cilat janë në përputhje me nevojat specifike të subjekteve ekonomike.

Biznesi është një aktivitet ekonomik. Aktiviteti i biznesit përfshin shërbimet, prodhimin, prodhimin e mallrave, aktivitetet e shpërndarjes: pra çdo gjë që dikush mund të prodhojë ose të shesë me qëllim që të ketë fitim.

Suksesi i një subjekti ekonomik kryesisht përcaktohet nga njohuritë, aftësitë, shkathtësitë, karakteristikat dhe përvojat e tyre¹. Kjo sugjeron që pronari-menaxheri duhet të marrë përsipër rolin e drejtuesit, të krijojë besim dhe të ketë aftësitë e nevojshme për të ndarë dhe shprehur qartë vizionin brenda subjektit². Në botë kemi shembuj të shumtë kur biznese të suksesshme kanë shkuar deri në prag të falimentimit apo kanë falimentuar siç e kemi shembullin e fundit me kompaninë ajrore Britanike *Thomas Cook* dhe të asaj Sllovene *Adria Airways*, vetëm për arsye se nuk e kanë kuptuar rëndësinë dhe domosdoshmërinë e menaxherëve në bizneset e tyre dhe se kanë pasur menaxhim të dobët me resurset që i kanë disponuar. Ose një shkak tjetër mund të jetë edhe mos plotësimi i nevojave të klientëve. Subjekti ekonomik duhet të ofrojë shërbime dhe prodhime që i plotësojnë nevojat e klientëve.

¹ Beaver Graham, Jennings Peter (2000), "Editorial overview: small business, entrepreneurship and enterprise development", Strategic Change, Vol. 9, Southampton, UK.

² Waldman, D.A., Yammarino Francis, (1999) "CEO charismatic leadership: levels of management and levels of analysis", Academy of Management Review, Vol. 24, Pennsylvania, USA.

Proceset e pashmangshme që ndodhin në mjedis të karakterizuar nga ndryshimi dinamik teknologjik, konkurrenca në rritje globale, pasiguria dhe rreziku, iniciojnë nevojën për krijimin dhe zhvillimin e subjekteve të vogla dhe të mesme, të cilat me risitë e tyre, kreativitetin, rritjen e përhershme në produktivitet dhe fleksibilitet, do t'u përshtaten kushteve të reja dhe do të kontribuojnë në mënyrë të konsiderueshme në zhvillimin e përgjithshëm shoqëror.

Zhvillimi i subjekteve të vogla dhe të mesme mundëson të ndihen efektet e tyre sa më shpejt të jetë e mundur në: punësim, rritjen e prodhimit, forcimin e konkurrencës, zhvillimin social dhe njerëzor në përgjithësi.

Aspektet teorike për zhvillimin e subjekteve të vogla dhe të mesme si subjekte të pavarura ekonomike dhe si mbajtës të aktiviteteve ekonomike janë subjekt i kërkimeve teorike dhe praktike ekonomike prej një kohe të hershme dhe për këtë shkak ka pikëpamje të shumta në trajtimin e subjekteve.

Duke kaluar nëpër faza të caktuara në zhvillimin e tij, subjekti ekonomik ka ndryshuar karakteristikat dhe përmbajtjen e vet. Si pasojë, autorë të ndryshëm e përcaktuan subjektin ekonomik në mënyrë të ndryshme. Përkufizimet përshkruajnë kohën dhe kushtet në të cilat ato janë bërë. Ato kanë bazën, pikëpamjet dhe pozicionin e autorëve si dhe qasjet e tyre subjektive në theksimin e veçorive më të rëndësishme të subjektit ekonomik. Prandaj, nuk duhet të ngatërrojmë grupin e përkufizimeve që mund të hasim.

Kështu, ekonomisti francez Jean-Gustave Courcelle-Seneuil e përcakton subjektin ekonomikë si "veprimtari njerëzorë që rregullon përdorimin e forcave të ndryshme për të arritur një qëllim të caktuar"³. Ky përkufizim i thjeshtë shfaqet në kohën e prodhimit industrial në shkallë të vogël.

Ekonomisti gjerman me influencë Eric Gutenberg është i mendimit se kompania është një sistem i lidhjes së duhur dhe modifikimit (kombinimit dhe transformimit) të faktorëve të prodhimit, duke realizuar kështu arritje të caktuara⁴. Gutenbergu thekson që, për të mundësuar mbijetesën ekonomike të subjektit ekonomik, është e nevojshme të respektohen parimet e

³ Jean-Gustave Courcelle-Seneuil, Subjektet ekonomike 1892. Paris, France

⁴ Erich Gutenberg, (1984) Subjektet ekonomike, Cologne, Germany.

ekonomisë (kostot minimale, përdorimi më racional i burimeve) dhe bilanci financiar (të ardhurat për mbulimin e shpenzimeve).

Richard Cyert, ekonomist amerikan dhe James Gardner March, profesor në Universitetin e Stanfordit, janë të mendimit se subjektet ekonomike paraqesin një "koalicion të individëve dhe grupeve me interesa konfliktuale që lidhen me aktivitetet e tyre⁵.

Subjekti ekonomik gjithashtu mund të përkufizohet si një organizatë tregtare në të cilën elementet e prodhimit janë të harmonizuara në mënyrë cilësore, sasiore dhe të përkohshme dhe që kryejnë funksione të caktuara në procesin e riprodhimit social.

Për subjektet moderne, Dimitar Bojadzioski është i mendimit se kompania është forma bazë e organizimit të veprimtarisë ekonomike dhe është një entitet i pavarur në pronësi të njësisive të caktuara. Kompania prodhon produkte dhe shërbime për nevojat e tregut, duke përdorur burime të caktuara dhe duke marrë rreziqe, për qëllime fitimi dhe qëllime të tjera ekonomike dhe sociale.

Disa elemente të rëndësishme të subjekteve ekonomike⁶:

- Subjekti është forma bazë e organizimit të aktivitetit ekonomik. Aktiviteti i përgjithshëm ekonomik i një vendi kryhet nëpërmjet subjekteve ekonomike. Respektivisht, subjekti ekonomik është një entitet nëpërmjet të të cilit një aktivitet ekonomik kryhet në mënyrë të organizuar në kushtet e një ekonomie tregu. Gjatë operimit të subjektit ekonomik, krijohen marrëdhënie të shumta midis burimeve ekonomike. Këto janë marrëdhëniet ndërmjet burimeve njerëzore (njerëzve), marrëdhëniet ndërmjet burimeve njerëzore dhe atyre materiale (pasurive) dhe marrëdhëniet ndërmjet vetë burimeve materiale.

- Subjekti është një entitet i pavarur. Pavarësia perceptohet si ekonomike / tregtare dhe ligjore. Si njësi e pavarur ekonomike, kompania furnizon burimet e nevojshme në treg dhe shet produktet dhe shërbimet e saj në treg për fitim. Ky lloj i pavarësisë është një shprehje e lirisë së subjektit ekonomik në mënyrën e përdorimit të burimeve të veta në dispozicion, në zgjedhjen e aktivitetit, zgjedhjen e metodave të prodhimit, llojet dhe burimet për prokurimin e burimeve, zgjedhjen e produkteve, vendet dhe kohën e blerjes dhe shitjes, si do të jetë cilësia e

⁵ Бојаџиески Димитар, Блажеска Олгица, (2003). Деловна економија, Економски факултет, Скопје.

⁶ Kotler Philip, Armstrong Gary, Saunders John, Wong Veronica (2010) Principle of marketing, botimi i tretë evropian, Financial Times, Illinois, USA.

produkteve, etj. Pavarësia ligjore do të thotë që subjekti ekonomik është një person juridik, me llogarinë e vet, selinë, pronën, organet drejtuese etj.

- Subjekti *është në pronësi të njërive të caktuara*. Sipas ligjeve, pronarët janë të ndryshëm (individë, shtet), d.m.th. ekziston një pluralizëm i pronësisë. Marrëdhëniet e ndryshme të pronësisë e kushtëzojnë ekzistencën dhe funksionimin e llojeve të ndryshme të ndërmarrjeve (private, të përziera, shtetërore ...).

-*Për nevojat e tregut, subjekti prodhon produkte dhe ofron shërbime*. Produktet dhe shërbimet paraqesin rezultate të operacioneve të subjektit ekonomik, të cilat varen nga aftësia e këtij subjekti për të përmbushur nevojat dhe dëshirat e konsumatorëve, respektivisht kërkesat e tregut.

- Subjekti *përdor burime*. Çdo njësi ekonomike përdor punën, mjetet e punës dhe objektet në punë si kontribute në procesin e punës.

- Subjekti *është një menaxher i riskut të biznesit*. Puna e tij mbart me vete pasigurinë, të shprehur si rrezik ose kanosje për humbjen e kapitalit të investuar.

- Subjekti *synon realizimin e fitimit dhe arritjen e qëllimeve të caktuara (ekonomike dhe sociale)*. Qëllimi përfundimtar që duhet të pritët nga ekzistenca dhe funksionimi i subjektit ekonomik ka qenë gjithmonë çështje urgjente. Disa ekonomistë argumentojnë se fitimi është qëllimi i vetëm që një ndërmarrje duhet të arrijë gjatë operimit të saj.

Blagoje Paunoviç është i mendimit se një subjekt ekonomik është një organizatë e pavarur e burimeve ekonomike që krijon vlerë duke transformuar inputet në rezultate për të arritur profitabilitetin⁷. Kjo tregon karakteristikat e mëposhtme të rëndësishme: Së pari, kompania është një entitet i pavarur ekonomik; Së dyti, kompania është e organizuar në një grup që ka krijuar lidhje të shumta midis burimeve ekonomike; Së treti, kompania krijon vlerë duke transformuar inputet në rezultate për të arritur profitabilitetin.

⁷ Paunoviç Blagoje (2009): "Ekonomika Preduzeča", Centar za ekonomsko obrazovanje, Ekonomskog fakulteta, 4 Izdanje, Beograd.

Gjegjësisht, funksionimi i subjektit ekonomik është një proces i transformimit të investimeve të caktuara në rezultate⁸. Duke funksionuar, subjekti krijon vlera. Procesi i krijimit të vlerës mund të ndahet në tri faza.

Në fazën e parë, subjekti investon burime, të cilat në fazën e dytë - procesi i prodhimit ose procesi i ofrimit të shërbimeve - transformohen në rezultate dhe në fazën e tretë realizohen rezultatet e funksionimit të subjektit.

Demsetz-i, si përfaqësues i modelit neoklasik, subjektet i përcakton si prodhim për konsumatorët, ose prodhim të destinuar për shitje jashtë tij⁹. Sipas teorisë neoklasike, subjektet janë njësitë e specializuara për prodhim, të cilat mund të bëhen edhe nga një person i vetëm. Subjektet prodhojnë për t'i përmbushur nevojat e konsumatorëve. Teoria është e ndërtuar në imagjinatë, por funksionimi i besueshmërisë se prodhimi dhe kërkesa vendos rregullin e maksimizimit të profitit në bazë të të cilit: fitimi është maksimal kur të ardhurat marginale janë të barabarta me kostot marginale. Kritika e teorisë neoklasike përqendrohet në supozimet e më poshtme: subjektet shpesh kërkojnë që të maksimizojnë pjesëmarrjen e tyre në treg dhe të realizojnë fitim. Domethënë, kompanitë shpesh përballen me problemin *Principle agent*, sepse pronarët janë të interesuar në maksimizimin e fitimit, kurse të punësuarit jo. Në fakt të punësuarit luftojnë që të kënaqin pronarët e tyre dhe kërkojnë që të përmbushen nevojat e tyre ose punësimi i tyre të jetë i përhershëm.

Hart-i e kritikon modelin neoklasik duke deklaruar se teoria tërësisht i injoron problemet nismëtare në kuadër të subjektit, subjekti është efikas në mënyrë të përkryer, teoria "kuti e zezë" aspak nuk përmbahet në organizimin e brendshëm të subjektit, nuk ka shpjegim për strukturën hierarkike dhe për procesin e vendim-marrjes; teoria nuk jep asnjë shpjegim për kufijtë e subjektit¹⁰.

Teoria e kostove të transaksionit, krijues i së cilës është Robert Coase, është një teori në të cilën Coase mundohet t'u përgjigjet dy pyetjeve kryesore: përse ekzistojnë subjektet dhe përse çdo subjekt ka madhësi të caktuar (cili është kufiri më i lartë i tij)? Themelet e koston së

⁸ Мателиевска Маргарита, Паческоски Влатко, (2011). Економија на трговски друштва, Скопје

⁹ Demsetz Harold, (1995) "The economics of the business firm: Seven critical commentaries", Cambridge University Press, California, USA.

¹⁰ Hart O., Moore J., (1990) "Property rights and the nature of the firm", Journal of Political Economy

transaksionit janë paraqitur në artikullin e Coase-së "Natyra e subjektit" në vitin 1937 dhe për këtë artikull në vitin 1991 Coase e merr çmimin Nobel¹¹. Duke pasur parasysh që prodhimi mund të bëhet pa subjekte, Coase pyet: përse dhe në cilat kushte duhet të presim subjektet të shfaqen? Në një botë të dijes që nuk ka çmim ata nuk kanë logjikë, por në një botë ku vazhdimisht zbulohen mundësi dhe ku nënshkrimi i kontratës në mes individëve është një aktivitet i shtrenjete, subjekti mund të shihet si një mjet për të ulur koston e arritjes së një përpjekjeje të koordinuar.

Shkaku kryesorë për shfaqjen e subjekteve sipas Coase është ekzistenca e kostove të transaksionit, të lëshuara me përdorimin e mekanizmave të tregut.

Teoria e evolucionit, fokusohet kryesisht në aspektet teknologjike të prodhimit dhe nxjerr në pah natyrën njohëse të strukturës organizative të subjektit¹². Kjo teori e përcakton subjektin si "përpunues i dijes" në krahasim me teoritë tradicionale që e përcaktojnë subjektin si "përpunues i informacionit". Teoria e evolucionit ofron një qasje alternative për shpjegimin e subjektit të bazuar në rutinë. Përfaqësuesit më me zë janë Nelson dhe Vinter, të cilët me termin rutinë nënkuptojnë dy aspekte të ndryshme, aspektin njohës të mësimi dhe dijes në njërin anë dhe në anën tjetër aspektet organizative për mbështetje, monitorim dhe kontroll¹³.

Teoritë e lartpërmendura nxjerrin në pah organizimin e subjekteve, ndërsa teoria e lojës përqendrohet në zhvillimin dhe mbijetesën e subjekteve në kushte konkurruese ekonomike.

Teoria e lojës përqipet të shpjegojë sjelljen strategjike të subjekteve gjatë vendimmarrjes në kushte konkurruese dhe pasigurie¹⁴. Në fakt, teoria e lojës paraqet një disiplinë të veçantë matematikore, që merret me formalizimin e përcaktimit të vendimeve optimale në kushte konflikti, konflikte të pjesshme ose në kushte të pasigurisë.

Duke ndjekur zhvillimin e subjekteve në teoritë e ndryshme mund të konstatohet se në kapitalizmin klasik, prej aspektit teorik dhe aplikativ, parësinë e zënë subjektet e vogla dhe të mesme, d.m.th. në kapitalizmin klasik krijohen subjektet e para të vogla private, kryesisht të

¹¹ Coase R.H., (1937) "The nature of the firm", London, UK.

¹² Fransman Martin, (1994) "Information Knowledge, Vision and Theories of the Firm"- Industrial and Corporate Change, Edinburg, USA.

¹³ Richard.R. Nelson, and Sidney Winter, (1982) "An Evolutionary Theory of Economic Change", The Belknap Press, Cambridge MA, USA.

¹⁴ Стојков Милан, (2008) "Развој на економската мисла", Скопје.

tipit prodhues, ndërsa krijimi i subjekteve të mëdha ishte i kufizuar për shkak të nivelit të zhvillimit ekonomik, shkallës së koncentrimit dhe për shkak se centralizimi ka qenë shumë i ulët.

1.2 Llojet e subjekteve ekonomike sipas ligjit të SHT-RMV

Në vitin 2004 me ndryshimin e ligjit për subjektet ekonomike, Maqedonia e Veriut e pranoi metodologjinë e Komisionit Evropian për klasifikimin e subjekteve sipas madhësisë¹⁵. Në bazë të kësaj metodologjie, sipas tre kritereve (numri i të punësuarve, madhësia e qarkullimit dhe gjithsej vlera e aseteve operative), subjektet klasifikohen në mikro, të vogla, të mesme dhe të mëdha. Në këtë mënyrë, kriteri i parë i metodologjisë (numri i të punësuarve) zbatohet edhe në Maqedoninë e Veriut (Mikro deri në 10 të punësuar, të vogla deri në 50 të punësuar, të mesme deri në 250 të punësuar dhe të mëdha mbi 250 të punësuar), ndërsa dy kriteret e tjera janë të zvogëluara në përputhje me rastin e Maqedonisë së Veriut (p.sh. subjekte të vogla janë ato me qarkullim vjetor deri në 2 milionë euro, në dallim me vendet në EU ku kjo vlerë është 10 milionë euro).

Klasifikimi i subjekteve në RMV sipas madhësisë së tyre, bëhet në përputhje me përkufizimin e ndryshuar të Komisionit Evropian nga muaj maj i vitit 2003, kështu që merren parasysh këto kritere: numri i të punësuarve, qarkullimi i mjeteve ose bilanci i gjendjes. Klasifikimi i tillë është paraqitur në tabelë.

Regjistri Statistikor i subjekteve ekonomike mbulon subjektet ekonomike me seli në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe njësitë e tyre organizative, pavarësisht nga madhësia, forma e organizimit, sektori institucional dhe sektori i aktiviteteve nga Klasifikimi Kombëtar i Aktiviteteve - NKD Rev.2, në të cilin janë të ndara sipas veprimtarisë kryesore që ato kryejnë e të cilat janë regjistruar më parë nga autoriteti kompetent si Regjistri Qendror. Më poshtë ju sjellim disa përkufizime për subjektet ekonomike¹⁶:

Si kriter themelor për përcaktimin e aktivitetit bazë të subjektit janë:

¹⁵ Enti Shtetëror i Statistikës në RMV Raporti i subjekteve ekonomike aktive

¹⁶ Enti Shtetëror i Statistikës në RMV

- **Ndërmarrje tregtare** janë të gjithë personat fizikë ose juridikë të cilët kryejnë ndonjë prej aktiviteteve të identifikuar në klasifikimin nacional të aktiviteteve, me seli në RMV, të regjistruara nga autoriteti kompetent në pajtim me ligjin dhe njësitë organizative të subjekteve të huaja që kryejnë biznes në territorin e RMV.
- **Persona juridikë** janë të gjitha format ligjore të organizuara sipas rregullave të vendit (ndërmarrjet tregtare, institucionet, shoqatat dhe organizatat e tjera) me të drejtat dhe detyrimet e caktuara, të cilët statusin e personit juridik e fitojnë në datën e regjistrimit të tyre në regjistrin përkatës kompetent (në Maqedoninë e Veriut është Regjistri Qendror).
- **Personat fizikë** janë subjektet (tregtarët individualë, mjeshtërit, fermerët individualë, ekzekutuesit e pavarur të aktiviteteve) të cilët posedojnë të drejta dhe detyrime dhe statusi i subjektit u pranohet në bazë të legjislacionit ekzistues.
- **Ndërmarrjet aktive** janë të gjitha subjektet afariste që marrin pjesë në krijimin e produktit të brendshëm bruto dhe kanë të dhëna mbi të ardhurat ose të punësuarit.
- **Veprimtaria kryesore** është aktiviteti që ka pjesën më të madhe në të ardhurat e subjektit, të fituar nga kryerja e aktiviteteve.

- Subjektet ekonomike ne bazë të Ligjit për shoqëritë tregtare

Subjektet ekonomike në bazë të Ligjit për subjektet tregtare mund të grupohen në bazë të kriterëve të ndryshme: madhësisë, pronësisë, formës organizative, rolit në procesin e riprodhimit shoqëror (sipas funksioneve në procesin e riprodhimit) etj.¹⁷

Tregtar individual - është një person fizik i cili kryen një nga aktivitetet e përcaktuara me ligj. Ai e kryen veprimtarinë në subjektin e tij, kryen kontrollin, mbart përgjegjësi të plotë për detyrimet e ndërmarra me pasurinë e tij, kryen negociata dhe të gjitha fitimet nga operacioni janë pronë e tij. Tregtari individual duhet të përmbajë: emrin e tij personal, emrin dhe

¹⁷ Ligji mbi ndërmarrjet tregtare, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 28/2004; 84/2005; 25/2007; 87/2008; 42/2010; 48/2010; 24/2011; 166/2012; 70/2013; 119/2013; 120/2013; 187/2013; 38/2014; 41/2014; 138/2014; 88/2015; 192/2015, 6/2016 dhe 61/2016 llojet e subjekteve ekonomike

mbiemrin e babait dhe duhet të përfshijë shenjë TI. Nuk mund të jetë një person juridik, por vetëm një person fizik.

Shoqëria tregtare - është subjekt i dy ose më shumë personave juridikë ose fizikë. Subjektet e tyre bazohen në investimin e parave, objekteve ose të drejtave pronësore që përdoren për operacione të përbashkëta. Në Regjistrin Tregtar regjistrohet si person juridik.

Shoqëria tregtare nuk ka prona në emër të subjektit. Prona e përdorur për operacione të përbashkëta është pronësi private e partnerëve. Për detyrimet ndaj palëve të treta të krijuara nga cilido nga partnerët, përgjegjës është çdo partner.

Me akt të veçantë (statuti i shoqërisë) përcaktohet forma, selia, subjekti i veprimeve, shumata e kapitalit bazë, organizimi dhe mënyra e menaxhimit.

Subjektet ekonomike, si bartës të rëndësishëm të aktivitetit ekonomik, janë të një rëndësie vendimtare për zhvillimin e ekonomisë kombëtare, në ekonominë e Maqedonisë së Veriut. Themelimi dhe funksionimi i tyre është rregulluar me ligjin për subjektet tregtare. Në bazë të këtij ligji, subjektet ekonomike mund të organizohen si¹⁸:

- Subjekt publik,
- Subjekt komandit (partneritet i kufizuar),
- Subjekt me përgjegjësi të kufizuar,
- Shoqëri aksionare dhe
- Shoqëri komandite me aksione.

Më poshtë do të sqarojmë karakteristikat e këtyre subjekteve:

Subjekt tregtarë publik¹⁹ - është kur bashkohen dy ose më tepër persona fizikë ose juridikë, të cilët, për detyrimet e subjektit, ndaj kreditorëve kanë përgjegjësi të pa kufizuar me gjithë mjetet e tyre. Subjekti themelohet me marrëveshje të partnerëve, e cila marrëveshje bëhet me shkrim dhe është dokument i domosdoshëm për themelimin e tij. Me kontratë

¹⁸ Ligji mbi ndërmarrjet tregtare, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 28/2004; 84/2005; 25/2007; 87/2008; 42/2010; 48/2010; 24/2011; 166/2012; 70/2013; 119/2013; 120/2013; 187/2013; 38/2014; 41/2014; 138/2014; 88/2015; 192/2015, 6/2016 dhe 61/2016 neni 19,20 , llojet e subjekteve ekonomike

¹⁹ Ligji mbi ndërmarrjet tregtare, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 28/2004; 84/2005; 25/2007; 87/2008; 42/2010; 48/2010; 24/2011; 166/2012; 70/2013; 119/2013; 120/2013; 187/2013; 38/2014; 41/2014; 138/2014; 88/2015; 192/2015, 6/2016 dhe 61/2016, neni 110

rregullohet mënyra e punës, lloji dhe sasia e kapitalit të secilit partner, mënyra e të punuarit, mënyra e ndarjes së fitimit dhe kështu me radhë. Kapitali i partnerëve mund të jetë i ndryshëm, d.m.th. partneri mund të deponojë para, mjete dhe shërbime (vlerën e mjeteve partnerët e caktojnë me marrëveshje, në para). Menaxhimi me subjektin mund të jetë nga të gjithë anëtarët, por për arsye praktike është vërtetuar se menaxhimi është më mirë t'i besohet njërit prej partnerëve. Fitimi dhe humbja ndahet në mes të partnerëve në përpjesëtim me pjesëmarrjen e secilit partner, përveç kur në kontratë është parashikuar ndryshe. Subjekti publik pushon së ekzistuari nëse: merret vendim nga të gjithë partnerët, falimenton subjekti, falimenton ndonjëri nga partnerët, merret vendim nga gjykata dhe në raste të tjera të përcaktuara me ligj.

Partneritet i kufizuar²⁰ - është subjekt ekonomik në të cilin bashkohen dy ose më shumë persona fizikë ose juridikë prej të cilëve më së paku njëri nga partnerët përgjigjet për detyrimet e subjektit me të gjithë pasurinë e tij, në fakt me përgjegjësi të pa kufizuar dhe individualisht, në rast se janë së paku dy partnerë (komplementarë), ndërsa së paku njëri partner përgjigjet për detyrimet e subjektit deri në vlerën e shënuar si kapital i subjektit. Komplementarët marrin pjesë me të paktën një të pestën e shumës totale të kapitalit. Komplementarët për detyrimet e subjektit përgjigjen në mënyrë të pa kufizuar me pronën e tyre, kurse partnerët për detyrimet e kompanisë përgjigjen deri në vlerën e shënuar në subjekt si kapital.

Subjekt komandit (partneritet i kufizuar), themelohet me kontratë me shkrim, e cila e ka këtë përmbajtje: Emri dhe adresa e subjektit, veprimtaria me të cilën do të merret subjekti, emri dhe mbiemri, numri amë, profesioni, numri i pasaportës ose letrës së njoftimit, vendbanimi, numri amë i subjektit, vlera totale e kapitalit të partnerëve dhe statusi i tyre në subjekt, lloji dhe përqindja e kapitalit e secilit partner, mënyra dhe koha e pagesës së kapitalit, menaxhimi i subjektit me partneritet dhe mënyra e marrjes së vendimeve etj.²¹. Fitimi ndahet në mes tyre

²⁰ Ligji mbi ndërmarrjet tregtare, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 28/2004; 84/2005; 25/2007; 87/2008; 42/2010; 48/2010; 24/2011; 166/2012; 70/2013; 119/2013; 120/2013; 187/2013; 38/2014; 41/2014; 138/2014; 88/2015; 192/2015, 6/2016 dhe 61/2016, neni 148

²¹ Ligji mbi ndërmarrjet tregëtare, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 28/2004; 84/2005; 25/2007; 87/2008; 42/2010; 48/2010; 24/2011; 166/2012; 70/2013; 119/2013; 120/2013; 187/2013; 38/2014; 41/2014; 138/2014; 88/2015; 192/2015, 6/2016 dhe 61/2016 neni 150,151

në bazë të pjesës së secilit partner. Deri te ndërprerja e punës së subjektit vjen nga vendim i marrë nga gjykata dhe në raste të tjera të përcaktuara me ligj.

Subjekt me përgjegjësi të kufizuar²²- është subjekti tregtar, në të cilin një ose më tepër persona fizikë ose juridikë marrin pjesë me depozitë në kapitalin themelues të kontraktuar më herët. Subjekti themelohet me kontratë në formë të shkruar që e nënshkruajnë të gjithë themeluesit. Kontrata përmban: emrin dhe mbiemri, numrin amë, numrin e pasaportës ose të letrës së njoftimit, vendbanimin, numrin amë të subjektit, adresën e subjektit, vlerën e kapitalit themelues dhe vlerën e depozitimit të secilit partner, mënyrën dhe kohën e pagesës së kapitalit, të drejtat dhe detyrimet që i kanë partnerët drejt subjektit, mënyrën e ndarjes së fitimit dhe mbulesës së humbjes, menaxhimin me subjektin, përfaqësimin e subjektit dhe mbylljen e subjektit. Deponimi i kapitalit mund të jetë në para dhe në mjete. Gjithsej deponimet e partnerëve e përbëjnë kapitalin themelues të subjektit. Kapital i cili nuk mund të jetë më i ulët se 5.000 euro në kundërvlerë në denarë. Subjekti drejtohet nga një menaxher, person fizik ose nga grupi i partnerëve. Grupin e partnerëve e përbëjnë të gjithë partnerët e subjektit

Subjekti mund të pushojë se ekzistuar në këto raste: vendimi i partnerëve, falimentimi ose bashkimi i subjektit me një subjekt tjetër. Shumica e subjekteve në Republikën e Maqedonisë së Veriut janë regjistruar si subjekt me përgjegjësi të kufizuar.

Shoqëri aksionare²³ - ofrojnë përparësi të mëdha dhe përfaqësojnë një formë të shpeshtë të organizimit të subjekteve. Subjekti aksionar është subjekt tregtar kapitali i të cilit është ndarë në pjesë të njëjta-aksione. Personat, të cilët marrin pjesë me depozita në kapitalin themelues, llogariten si aksionarë dhe ata i kanë të gjitha të drejtat që mund ti ketë një posedues aksioni.

Themelimi i subjektit mund të jetë simultan (i menjëhershëm) dhe sukcesiv. Vlera nominale e kapitalit themelues gjatë themelimit të subjektit similtiv, pa thirrje publike për

²² Ligji mbi ndërmarrjet tregtare, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 28/2004; 84/2005; 25/2007; 87/2008; 42/2010; 48/2010; 24/2011; 166/2012; 70/2013; 119/2013; 120/2013; 187/2013; 38/2014; 41/2014; 138/2014; 88/2015; 192/2015, 6/2016 dhe 61/2016 neni 166,167

²³ Ligji mbi ndërmarrjet tregtare, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 28/2004; 84/2005; 25/2007; 87/2008; 42/2010; 48/2010; 24/2011; 166/2012; 70/2013; 119/2013; 120/2013; 187/2013; 38/2014; 41/2014; 138/2014; 88/2015; 192/2015, 6/2016 dhe 61/2016 neni 270,271,273

emetimin e aksioneve është 25.000 euro, ndërsa kur subjekti themelohet në mënyrë sukcesive (nëpërmjet thirrjes publike për emetimin e aksioneve), kapitali themelues është së paku 50.000 euro. Aksionet mund të jenë të thjeshta ose prioritare, ndërsa vlera nominale e aksionit nuk mund të jetë më e vogël se 1 euro. Aksionet lëshohen, transferohen dhe mbahen në formë elektronike në depozitën qendrore të letrave me vlerë të RMV-së. Subjekti në përputhje me ligjin dhe statutin, mund të lëshojë obligacione të konvertueshme deri në vlerën e kapitalit themelues, të cilat kreditorëve ua jep të drejtën t'i nderojnë aksionet, pastaj mund të nënshkruajnë kontrata me zgjedhje për blerjen dhe shitjen e obligacioneve, si dhe kontratë fjuçërs (të së ardhmes), në mënyrë dhe në bazë të kushteve të përcaktuara në statut. Menaxhimi mund të jetë i organizuar në një nivel (bordi drejtues) dhe në dy nivele (drejtori dhe këshilli mbikëqyrës).

Subjekti ndalet së punuari në këto raste: vendimi i kuvendit, vendim gjyqësorë, bashkim ose ndarja e subjektit, falimentim, etj.

Subjekti me partneritet me aksione²⁴- është subjekt tregtar, kapitali themelues i të cilit është i ndarë në aksione dhe njëri ose më shumë partnerë në mënyrë të pa kufizuar dhe individualisht përgjigjen për detyrimet e subjektit. Ajo themelohet me anë të kontratës që e nënshkruajnë të gjithë themeluesit. Me subjektin menaxhojnë **komplementarët** vetëm në rast kur ato të drejtën e tyre të menaxhimit nuk ia kanë besuar njërit ose më shumë menaxherëve. Këshilli mbikëqyrës bën kontroll të përhershëm mbi menaxhimin me subjektin. Kuvendit të subjektit me partneritet (komandit) me aksione bordi mbikëqyrës iu dorëzon raport vjetor, në të cilin tregohen të gjitha parregullsitë dhe pasaktësitë.

Në bazë të karakteristikave të lartpërmendura mund të vijmë në përfundim që ka shumë përparësi dhe mangësi në subjekte të ndryshme tregtare. Kështu për shembull, mangësi e subjektit publik tregtar me partneritet dhe atij me partneritet me aksione është përgjegjësia e pakufizuar e partnerit. Kur subjekti themelohet nga dy themelues, ka mundësi të rrezikohet ekzistenca e subjektit në rast të vdekjes së njërit nga themeluesit. Për atë thuhet se partneriteti nuk ka jetë të përhershme. Një nga problemet kryesore të subjektit është sigurimi i kapitalit.

²⁴ Ligji mbi ndërmarrjet tregtare, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 28/2004; 84/2005; 25/2007; 87/2008; 42/2010; 48/2010; 24/2011; 166/2012; 70/2013; 119/2013; 120/2013; 187/2013; 38/2014; 41/2014; 138/2014; 88/2015; 192/2015, 6/2016 dhe 61/2016

Tek subjektet aksionare dhe komandite me aksione ka mundësi të sigurimit të kapitalit përmes emetimit të letrave me vlerë, që nuk mund të bëhet te subjektet e tjera tregtare, të cilat mungesën e kapitalit e kompensojnë me përfshirje të partnerit të ri ose me ndonjë kredi të lartë.

Në Republikën e Maqedonisë së Veriut subjektet e vogla dhe të mesme në shumicën e rasteve paraqiten si Shoqëri të themeluar nga një person dhe Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, edhe përkundër përparësive të mëdha që i ka shoqëria aksionare. Shkak për këtë është fakti se përgjithësisht jemi të informuar shumë pak për përparësitë e emetimit të aksioneve, si dhe frika nga bërja publike e raporteve financiare dhe marrja e pronës dhe menaxhimit me subjektin.

1.3 Llojet e subjekteve ekonomike në UE

Në çdo ekonomi dinamike duke pasur parasysh ndryshimet në kushtet e menaxhimit dhe qeverisjes së rregullave të tregut, parakushti themelor për sukses është funksionimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme. Ato bëhen sektor dominues, por në asnjë rast nuk duhet lënë pas dore rolin e kompanive të mëdha për zhvillimin ekonomik, sepse ato ende kanë efikasitet dhe produktivitet të madh dhe një ofertë të madhe për pushtimin e tregjeve botërore. Ka shumë arsye për përcaktimin e madhësisë së subjekteve, p.sh. nevoja e monitorimit statistikor, rregulloret të kontabilitetit, rregulloret tatimore etj. Duke pasur parasysh faktin që subjektet janë një grup heterogjen, është e vështirë të përcaktohet një kriter i vetëm apo një kombinim i vetëm kriteresh, që do të japin një përgjigje definitive dhe unike. Në mënyrë tipike, gjatë përcaktimit të madhësisë së subjektit fillohet nga qasja sasiore dhe kualitative. Si kritere sasiore janë: pjesëmarrja në treg e subjektit; shkalla e përqendrimit; madhësia e shitjeve; madhësia e fitimit; numri i të punësuarve etj. Por ndonjëherë këto kritere ndryshojnë në vende të ndryshme, në varësi të legjislacionit.

Përkufizimi evropian për subjektet e vogla dhe të mesme është ky ²⁵: Kategoria e subjekteve mikro, të vogla dhe të mesme është e krijuar nga subjekte që punësojnë më pak se

²⁵ Komisioni Evropian, <https://ec.europa.eu>

250 të punësuar dhe që kanë qarkullim vjetorë që nuk e kalon vlerën 50 milion euro, ose bilanci i gjendjes që nuk e kalon vlerën 43 milion euro.

Tabela 1. Klasifikimi i subjekteve të UE-së

Kategoria e subjekteve	Numri i të punësuarve	Qarkullimi mjeteve	se	Bilanci i gjendjes
Të mesme	< 250	≤ 50 milion €		≤ 43 milion €
Të vogla	< 50	≤ 10 milion €		≤ 10 milion €
Mikro	< 10	≤ 2 milion €		≤ 2 milion €

Burimi: http://ec.europa.eu/The_definition_of_SMEs_according_to_the_European_Commission_recommendation_2003/361/EC

Nga të dhënat në tabelën nr.1 mund të shihet që subjektet që kanë deri në 250 të punësuar, fitim vjetor deri në 50 milion euro dhe vlerë vjetore totale të aktives 43 milion euro, determinohen si të mesme, përderisa subjektet e vogla kanë deri në 50 të punësuar, fitim vjetor jo më shumë se 10 milion euro dhe vlerë totale vjetore të aktivës deri në 10 milion euro dhe në grupin e subjekteve mikro bëjnë pjesë ato subjekte që kanë deri në 10 të punësuar, fitim vjetor jo më shumë se 2 milion euro dhe vlerë totale vjetore të aktivës deri në 2 milion euro.

Vendet anëtare të BE-së kanë pasur përkufizime individuale të asaj që përbën një subjekt të vogël dhe të mesëm²⁶. Për shembull, përkufizimi në Gjermani kishte një kufi prej 255 punonjësish, ndërsa në Belgjikë një numër prej 100. Kjo bën që një biznes belg prej 249 punonjësve do të kishte tatim me normë të plotë në Belgjikë. Në Mbretërinë e Bashkuar, një kompani përcaktohet si një subjekt i mesëm apo i vogël nëse plotëson dy nga tre kriteret: ka një qarkullim prej më pak se 25 milion, ka më pak se 250 punonjës, ka asete bruto më pak se 12.5 milion paund sterlinë.

Për shkak të faktit që subjektet e vogla dhe të mesme veprojnë në treg të vetëm, pa kufij të brendshëm, inicohet një përkufizim i vetëm për efikasitet dhe qëndrueshmëri të tyre.

²⁶ Ристеска Анета, (2013) Докторатурска дисертација, Влијание на малите и средните претпријатија врз економскиот развој, со посебен осврт на РМ, Прилеп

Në këtë drejtim Komisioni Evropian ka dhënë një përkufizim për subjektet e vogla dhe të mesme dhe në bazë të modifikimit të tij të fundit merren parasysh këto kritere: numri i të punësuarve, fitimi vjetor dhe vlera vjetore e totalit të aktiveve²⁷.

Përkufizimi është instrument i rëndësishëm për zbatimin e masave efektive dhe të programit për të mbështetur zhvillimin dhe suksesin e subjekteve të vogla dhe të mesme. Për këtë arsye Komisioni Evropian në marrëveshje me Bankën Evropiane të Investimeve dhe Fondin Evropian të Investimeve, bëjnë thirrje për implementim më të gjerë të tij, posaçërisht në shtetet e UE²⁸.

2. Struktura dhe trendi i subjekteve ekonomike sipas madhësisë dhe veprimtarive ekonomike ne RMV

Në këtë kapitull do të analizohen subjektet ekonomike sipas madhësisë në RMV, sipas sektorëve të veprimtarive ekonomike dhe sipas regjioneve, ku kemi bërë një analizë të veçantë për regjionin e Pollogut.

2.1 Analiza e subjekteve ekonomike sipas madhësisë në RMV për periudhën kohore 2011-2018

Në bazë të “Ligjit mbi shoqëritë tregtare” të vitit 2004 është konceptuar një përkufizim i ngjashëm me përkufizimin ekzistues të Bashkimit Evropian mbi klasifikimin e subjekteve (bizneseve) në mikro subjekte, subjekte të vogla, subjekte të mesme dhe subjekte të mëdha. Kriteret për klasifikimin e këtillë janë:

²⁷ Ристеска Анета, (2013) Докторатурска дисертација, Влијание на малите и средните претпријатија врз економскиот развој, со посебен осврт на РМ, Прилеп

²⁸ <http://ec.europa.eu>

Tabela 2. Kategoritë e subjekteve ekonomike

Kategoria e subjekteve	Numri i të punësuarve	Qarkullimi i mjeteve në €
Mikro subjekte	1-9	<50.000,00
Subjekte të vogla	10-50	≤ 2 milion
Subjekte të mesme	51-249	≤ 10 milion
Subjekte të mëdha	250>	

Burimi: Enti Shtetëror i Statistikës, RMV.

Në bazë të analizës që e bëjmë prej vitin 2011 në Maqedoninë e Veriut numri i subjekteve është zvogëluar nga viti në vit deri në vitin 2018²⁹. Kjo vjen si rezultat i kushteve jo të mira për të bërë biznes, por edhe nga shkakut e shpërnguljes të popullatës në vendet evropiane, gjë që ndikon në uljen e konsumit, kurse kjo automatikisht ndikon edhe në suksesin e subjekteve.

Tabela 3. Analiza e subjekteve ekonomike sipas madhësisë në RMV (2011-2018)

Republika e Maqedonisë	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018
Gjithsej	73 118	74 424	71 290	70 659	70 139	71 519	71 419	72 315
Mikro	46 322	53 117	49 935	49 539	48 611	49 364	48 577	48 778
Të vogla	25 984	20 341	20 241	19 937	20 313	20 892	21 543	22 138
Të mesme	607	631	683	724	725	746	776	840
Të mëdha	205	335	431	459	490	517	523	559

Burimi: Enti Shtetëror i Statistikës RMV.

-Në vitin 2011 numri i përgjithshëm i subjekteve është 73.118 prej të cilave numri i subjekteve mikro është më i madh 46.322, numri i subjektet e vogla është 25.984, i atyre të mesme është 607 dhe numri i subjekteve të mëdha është më i vogël 205.

²⁹ Enti Shtetëror i Statistikës në RMV Analiza e subjekteve ekonomike sipas madhësisë

-Në vitin 2013, në krahasim me vitin 2012, ka filluar trendi i rënies së numrit të subjekteve në përgjithësi dhe mund të vërehet që numri i subjekteve nga 74.424 ka rënë në 71.290. Rënie më të madhe kanë pasur subjektet mikro që kanë rënë në 49.935. Numri i subjekteve të vogla ka qenë 20.241, i atyre të mesme 683 dhe subjektet e mëdha në dallim nga grupet e tjera kanë shënuar rritje nga 335 në 431.

-Në vitin 2015 numri i përgjithshëm i subjekteve ka qenë 70.139, ku mund të shohim se ato mikro kanë vazhduar me ulje të numrit në 48.611, të voglat kanë pasur rritje në 20.131, të mesmet kanë ngelur pothuajse në numër të njëjtë - 725, dhe të mëdhatë kanë pasur rritje në 490.

- Në dallim nga vitet e tjera kur kishte një ritëm rënës të numrit të ndërmarrjeve në përgjithësi në Maqedoninë e Veriut, në vitin 2016 shohim që kemi rritje të këtij numri. E gjithë kjo vjen si rezultat i bashkëpunimit të shtetit me UNDP-në për pagesën e kontributeve të ndërmarrjeve atyre të reja dhe atyre ekzistuese për të ulur numrin e të papunësuarve, çka ka ndikuar edhe në rritjen e numrit të ndërmarrjeve në përgjithësi dhe kemi 1.380 ndërmarrje më shumë. Mikro kemi 49.364, të vogla 20.892, të mesme 746 dhe të mëdha 517 ndërmarrje.

- Pothuajse i njëjti trend ka ngelur edhe në vitin 2017, pasi që është mbyllur një numër i madh i subjekteve jo aktive dhe janë hapur subjekte të tjera që shfrytëzojnë grande të ndryshme nga UNDP. Numri i përgjithshëm i subjekteve ekonomike ka qenë 71.419, ku mund të shohim se ato mikro kanë vazhduar me ulje të numrit në 48.577, të voglat kanë pasur rritje në 21.543, të mesmet kanë pasur një rritje të vogël në 725, dhe të mëdhatë kanë pasur rritje në 523 subjekte aktive.

- Nëse e bëjmë një krahasim ndërmjet viteve 2011 dhe 2018 mund të vërehet që kemi rritje të numrit të subjekteve mikro nga 46 322 në 48 778 , te subjektet e vogla kemi ulje të subjekteve aktive nga 25 984 në 22 138, te subjektet e mesme kemi rritje prej 607 në 840 subjekte aktive dhe gjithashtu rritje ka edhe tek subjekte e mëdha prej 205 në 559 subjekte.

2.2 Analiza e subjekteve ekonomike sipas sektorëve të veprimtarive ekonomike në RMV për periudhën kohore 2011-2018

Në bazë të analizës së bërë për subjektet ekonomike sipas sektorëve të veprimtarive në RMV nga viti 2011 deri në vitin 2018 kemi pasur ndryshime të sektorëve të veprimtarive ekonomike secilin vit kalendarik.

Tabela 4. Analiza e subjekteve ekonomike sipas veprimtarive ekonomike në RMV (2011-2018)

	Republika e Maqedonisë së Veriut							
	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018
Gjithsej	73.118	74.424	71.29	70.659	70.139	71.519	71.419	72.315
Bujqësi, pylltari dhe peshkim	2.963	3.072	2.866	2.842	2.827	2.749	2.603	2.546
Industria përpunuese	8.155	8.251	7.918	7.675	7.639	7.967	7.885	8.033
Ndërtimtari	4.400	4.541	4.322	4.349	4.429	4.747	4.814	4.938
Tregti me shumicë dhe pakicë; riparimi i automjeteve dhe motoçikletave	27.468	27.307	25.429	24.674	23.843	23.716	23.337	22.950
Transport dhe magazinim	6.380	6.445	6.095	5.919	5.820	5.829	5.732	5.667
Turizëm dhe hotelieri	4.313	4.611	4.482	4.493	4.535	4.627	4.559	4.597
Informacion dhe komunikim	1.419	1.515	1.446	1.475	1.524	1.618	1.689	1.856
Aktivitetet profesionale, shkencore dhe teknike	5.369	5.707	5.817	6.095	6.261	6.618	6.948	7.261
Aktivitetet administrative	1.319	1.438	1.514	1.554	1.553	1.65	1.698	1.752
Aktivitetet shëndetësore dhe ndihmë sociale	3.246	3.298	3.315	3.322	3.313	3.298	3.319	3.357
Aktivitetet tjera shërbyese	4.257	4.232	4.147	4.212	4.265	4.362	4.427	4.804
Të tjerat	3.829	4.007	3.939	4.049	4.130	4.338	3.408	4.554

Burimi: Enti Shtetëror i Statistikës

Në bazë të Entit Shtetëror të Statistikave në vitin 2013 në Maqedoni kanë ekzistuar 71.290 subjekte aktive, në vitin 2014 numri i subjekteve aktive ka rënë ende dha ka pasur

70.659 dhe në vitin 2015 ka vazhduar trendi i rënies dhe numri i subjekteve aktive ka rënë dha ka pasur 70.139³⁰.

Në fund të vitit 2014, numri i subjekteve aktive ne Maqedoni ka arritur në 70.659, prej të cilave 24.674 ose 34.9% kanë qenë: prej sektorit të tregtisë me shumicë dhe me pakicë dhe riparimi i mjeteve vozitëse dhe 7.675 ose 10.9% kanë qenë prej industrisë së përpunimit. Në rast se i matim në bazë të numrit të të punësuarve, pjesëmarrje më të madhe (85.2%) kanë pasur subjektet mikro që kanë prej 1 deri në 9 të punësuar; 5.4% kanë qenë kompani që nuk kanë të punësuar; subjektet që kanë prej 10 deri në 19 të punësuar kanë pjesëmarrje prej 4.4%; 2.6% kanë pasur ato që kanë prej 20 deri në 49 të punësuar; 1.8% prej subjekteve kanë pasur ndërmjet 50 dhe 249 të punësuar, dhe vetëm 0.3% prej subjekteve kanë pasur mbi 250 të punësuar.

Në bazë te Entit Shtetëror të Statistikave të RMV, numri i subjekteve aktive ne RMV në vitin 2015 është 70.139. Pjesëmarrje më të madhe në këtë strukturë kanë sektorët: sektori i tregtisë me shumicë dhe me pakicë dhe riparimi i mjeteve vozitëse me 23.843 ose 34 %, dhe industria e përpunimit me 7.639 ose 10.9%. Numër më të vogël të përfaqësimit ka sektori i xehetarisë dhe nxjerrja e gurëve (173 subjekte ose 0.2%) dhe furnizimi me energji elektrike, gaz, avull dhe ajër të kondicionuar (160 subjekte ose 0.2%).

Në vitin 2017 dhe 2018 ka një numër më të madh të subjekteve ekonomike në krahasim me 2015, me çka automatikisht është rritur edhe numri i veprimtarive në veçanti. Rritje më të madhe ka në: aktivitetet profesionale, shkencore dhe teknike, informacionin dhe komunikimin dhe në aktivitetet administrative. Ndërkaq, edhe pse kemi një rritje të numrit të përgjithshëm për këto dy vjet, në disa veprimtari kemi ulje të numrit, siç janë veprimtaritë: tregtia me shumicë dhe pakicë; riparimi i automjeteve dhe motoçikletave, bujqësia, pylltaria dhe peshkimi, transporti dhe magazinimi.

³⁰ Enti Shtetëror i Statistikës në RMV Analiza e subjekteve ekonomike sipas sektorëve të veprimtarive ekonomike

2.3 Analiza e subjekteve ekonomike sipas regjioneve ne RMV me theks të veçantë për regjionin e Pollogut

Duke u bazuar në të dhënat zyrtare të Entit Shtetëror të Statistikave për periudhën kohore prej vitit 2011 deri në vitin 2018, periudhë për të cilën jemi duke bërë analiza ³¹, mund të vërejmë se edhe në vitin 2011, por edhe në vitet në vijim regjioni i Shkupit ka numrin më të madh të subjekteve.

Tabela 5. Analiza e subjekteve ekonomike sipas regjioneve ne RMV (2011-2018)

	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018
	Gjithsej	Gjithsej	Gjithsej	Gjithsej	Gjithsej	Gjithsej	Gjithsej	Gjithsej
Republika e Maqedonisë	73.118	74.424	71.290	70.659	70.139	71.519	71.419	72.315
Regjioni i Shkupit	28.095	28.563	26.859	26.848	26.197	26.842	26.947	27.612
Regjioni i Pellagonisë	8.308	8.468	8.268	8.127	8.071	8.061	8.064	8.118
Regjioni i Jugperëndimit	7.385	7.564	7.219	7.118	7.127	7.323	7.238	7.209
Regjioni i Pollogut	7.100	7.285	7.236	7.323	7.554	8.032	8.118	8.272
Regjioni i Vardarit	5.858	5.975	5.526	5.440	5.470	5.481	5.383	5.409
Regjioni i Lindjes	5.845	5.913	5.796	5.675	5.692	5.713	5.615	5.632
Regjioni i Juglindjes	6.248	6.373	6.083	5.969	5.889	5.972	5.970	5.985
Regjioni Verilindor	4.279	4.283	4.303	4.159	4.139	4.095	4.084	4.078

Burimi: Enti Shtetëror i Statistikës

Nëse e shohim tabelën nr.5, që pasqyron analizën e subjekteve ekonomike sipas regjioneve nga viti 2011 deri në vitin 2018 mund të vërejmë që gjatë viteve kemi pasur ngritje dhe ulje të subjekteve në regjione, në ndonjë regjion numri i subjekteve aktive përgjatë viteve është rritur, në ndonjë tjetër, edhe pse ka pasur një rritje të numrit total të subjekteve, numri i subjekteve në kuadër të atij regjioni ka shënuar ulje.

Mirëpo nëse bëjmë një krahasim për periudhën kohore ndërmjet viteve 2011 dhe 2018 mund të vërejmë që, për vitin 2011 regjioni i Shkupit ka 28.095 subjekte së bashku me ritmin e

³¹ Enti Shtetëror i Statistikës në RMV Analiza e subjekteve ekonomike sipas regjioneve

uljes totale të subjekteve aktive kemi edhe ulje për këtë regjion në 2018 me një numër prej 27.612, pastaj pason regjioni i Pellagonisë me 8.308 subjekte në 2011 dhe 8.111 në vitin 2018 ku gjithashtu si regjioni i Shkupit edhe ky regjion ka pasur ulje. Regjioni jugperëndimor vazhdon me të njëjtin trend të uljes me 7.385 subjekte në vitin 2011 dhe 7.209 në vitin 2018. Në dallim nga regjionet e lartpërmendura, të cilat kanë ulje të subjekteve, regjioni i Pollogut edhe përkundër uljes të numrit total të subjekteve, në vitin 2011 ka pasur 7.100 subjekte aktive dhe në vitin 2018 ka 8.272 subjekte ku mund të shohim që kemi rritje e kështu me radhë. Të gjitha regjionet e tjera shënojnë ulje.

2.3.1 Analiza e subjekteve ekonomike në regjionin e Pollogut.

Pasi temë të analizës kemi subjektet ekonomike në regjionin e Pollogut, më poshtë kemi një tabelë të posaçme me të dhëna nga Enti Shtetëror i Statistikës për këtë regjion³².

Tabela 6. Analiza e subjekteve ekonomike në regjionin e Pollogut, (2011-2018)

	Regjioni i Pollogut							
	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018
Gjithsej	7.100	7.285	7.236	7.323	7.554	8.032	8.118	8.272
0 të punësuar	317	302	217	192	355	424	398	427
1 – 9	6.414	6.592	6.620	6.707	6.756	7.122	7.214	7.323
10 – 49	288	306	313	335	347	382	398	408
50-249	75	79	79	81	89	96	100	106
250+	6	6	7	8	7	8	8	8

Burimi: Enti Shtetëror i Statistikës RMV

Nga tabela nr.6 mund të shohim që nga viti 2011 e deri në vitin 2018 kemi një rritje të subjekteve ekonomike aktive. Mund të shohim që në vitin 2011 kemi pasur gjithsej 7.100 subjekte aktive, nga të cilat numri më i madh i subjekteve ka qenë me nga 1 deri në 9 të punësuar siç kanë qenë 6.414 subjekte, pastaj vijnë subjektet e tjera. Nëse bëjmë një krahasim me vitin 2011, në vitin 2018 kemi 1.172 subjekte më shumë, por kjo nuk do të thotë që çdo vit kemi pasur rritje. Në vitin 2012 shënohet një rritje e vogël, pastaj në vitin 2012 dhe 2013 kriza ekonomike botërore ka ndikuar edhe tek ne dhe kështu kemi ulje të numrit. Në vitin 2014 fillon

³² Enti Shtetëror i Statistikës në RVM Analiza e subjekteve ekonomike sipas regjioneve

rritja graduale, ku në vitin 2014 kemi pasur 7.323 subjekte aktive në rajonin e Pollogut, pastaj në vitin 2015 kemi 7.554 subjekte aktive. Në vitin 2016 kemi pasur 8.032 subjekte aktive dhe kjo rritje e vogël ka vazhduar edhe në vitin 2018 ku kemi pasur 8.118 subjekte aktive. Do të ndalemi pak te viti 2018 ku mund të shohim që, njëlloj si në vitin 2011 edhe në këtë vit, numri më i madh i subjekteve në rajonin e Pollogut është tek ato subjekte me nga 1 – 9 të punësuar. Subjekte të tilla ka pasur 7.323, pastaj me 0 të punësuar ka pasur 427 subjekte dhe të tilla me nga 10 – 49 të punësuar ka pasur 408 subjekte ekonomike, me nga 50-249 kemi 106 dhe në fund me 250 e më shumë të punësuar kemi 8 subjekte ekonomike.

3. Raportet Financiare

Përmbajtja dhe karakteristikat e pasqyrave financiare

Menaxhmenti mban përgjegjësinë kryesore për pasqyrat financiare të subjektit afarist. Ekzistojnë edhe shtëpi revizore të cilat janë përgjegjëse për analizat financiare, por në të shumtën e rasteve ato e konfirmojnë vërtetësinë e tyre. Serioziteti dhe suksesi i një biznesi janë të lidhura me pasqyrat financiare dhe mënyrën se si ato janë bërë.

Raportet financiare e tregojnë realitetin ekonomik për punën e subjektit ekonomik dhe ato janë një mjet i dobishëm për menaxhimin dhe përdoruesit e tjerë dhe një bazë cilësore për vendimmarrje³³. Duke i lexuar ashtu siç duhet pasqyrat financiare, prej tyre mund të kuptohet forca financiare e subjektit ekonomik, mënyra e financimit të aktiviteteve, niveli i borxhit, struktura e kapitalit dhe rezultati i realizuar financiar.

Pasqyrat financiare përgatiten një herë në vit. Pasqyra financiare përmban bilancin e gjendjes, bilancin e suksesit, pasqyrën e fluksit të parasë, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe shënimet shtesë. Të gjitha këto pasqyra financiare janë të ndërlidhura, sepse ato pasqyrojnë aspekte të ndryshme të të njëjtave transaksione dhe secili raport ofron informacione që dallojnë nga njëri-tjetri, asnjëri nuk shërben vetëm për një qëllim.

³³ Xhafa Halit, Ciceri Beshir, (2006). Drejtimi financiar 1 botimi i tretë, Tiranë.

Menaxhmenti i subjektit ekonomik për të krijuar të dhëna financiare me cilësi të lartë duhet t'i lejojë punëtorët financiarë të përdorin zgjidhje të sofistikuara softuerike për përpunimin e të dhënave që do të jenë në përputhje me standardet ndërkombëtare të kontabilitetit dhe rregulloret ligjore vendore³⁴. Ky përpunim i të dhënave siguron sigurinë e tyre dhe prezantimin e duhur.

Pasqyrat financiare ofrojnë informacion mbi pozicionin financiar, rezultatet dhe flukset e mjeteve monetare të subjektit ekonomik që janë të dobishme për një numër të madh përdoruesish gjatë marrjes së vendimeve të biznesit. Pasqyrat financiare përshkruajnë rezultatet e menaxhimit të menaxhmentit, ose përgjegjësinë e menaxhmentit ndaj burimeve që u janë besuar atyre³⁵.

Pasqyrat financiare janë produkti kryesor që rezulton nga procesi i raportimit financiar. Raportimi financiar në Republikën e Maqedonisë së Veriut kryhet në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar. Prej 1 janarit të v. 2012, ka filluar zbatimin e Standardit Ndërkombëtar të Raportimit Financiar për subjektet ekonomike të vogla dhe të mesme. Zbatimi i SNRF për NVM-të rezulton me pasqyra financiare që sigurojnë një paraqitje objektive dhe reale të pozicionit financiar, të rezultateve financiare dhe të flukseve të mjeteve monetare të subjekteve ekonomike. Që objektiviteti i të dhënave që tregohen të jetë më i madh, është e nevojshme paraqitja më reale e efekteve të transaksioneve, ngjarjeve dhe kushteve të tjera në përputhje me përkufizimet dhe kriteret për njohjen e aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve³⁶.

Burimi bazë i të dhënave nga të cilat mund të bëhet një analizë efektive financiare janë pasqyrat financiare (bilancet) e subjektit ekonomik, shënimet, si dhe diskutimet me menaxherët. Në funksion të krahasimit me kompanitë konkurruese, analisti financiar përdor të dhënat përkatëse të krahasueshme nga kompanitë e tjera dhe statistikat kombëtare³⁷. Për fat të keq, një informacion i tillë në nivelin e ekonomisë kombëtare nuk është në dispozicion në

³⁴ Дрогирска Лорета, (2012) магистерски труд "Ревизија на финансиските извештаи, Комплетирање на ревизорски процес и издавање на конечен ревизорски извештај".

³⁵ Finance.gov.mk

³⁶ Димитриска-Кочоска Гордана, (2011). Стопанска Банка, второ издание на "Академија на Капитал", "Капитал", Скопје.

³⁷ Мателиевска Маргарита, Паческоски Влатко, (2011). Економија на трговски друштва, Скопје.

vendin tonë. Zyra Shtetërore e Statistikave ose Regjistri Qendror i Llogarive vjetore duhet të krijojnë një bazë të dhënash kombëtare të treguesve financiarë, sipas degëve (industrive), rajoneve etj., por edhe në nivel shtetëror. Krahasimi është një gjë e rëndësishme për të kuptuar vendin e biznesit - në aspektin e konkurrencës, të së kaluarës, brenda industrisë dhe shtetit.

Pasqyrat financiare duhet të përgatiten në përputhje me legjislacionin kombëtar, standardet ndërkombëtare të kontabilitetit dhe standardet ndërkombëtare të auditimit, duke garantuar kështu saktësinë dhe vërtetësinë e tyre. Konfirmimi i saktësisë dhe vërtetësisë së pasqyrave financiare ofrohet përmes auditimit të tyre.

Përdoruesit e analizës së pasqyrave financiare mund të ndahen në dy grupe më të gjera, të tilla si ³⁸ : Përdorues të brendshëm dhe përdorues të jashtëm.

Përdoruesit e brendshëm mund të ndahen në :

- Pronarët e kapitalit – të brendshëm
- Menaxhmenti i ndërmarrjes;
- Bordi i drejtorëve;
- Sindikatat etj.

Përdoruesit e jashtëm mund të ndahen në :

- Kreditorët;
- Sindikatat;
- Konkurrenca;
- Autoritete shtetërore;
- Zyrat e statistikave;
- Dhomat ekonomike;

Koncepti dhe llojet e pasqyrave financiare

Kontabiliteti mbledh dhe klasifikon informacionin ekonomik për përdoruesit që kanë nevojë për të marrë një vendim. Kontabiliteti i paraqet informacionet e tilla në raportet e quajtura pasqyra financiare. Për të përgatitur këto raporte, kontabilistët analizojnë, regjistrojnë, numërojnë, përmbledhin, raportojnë dhe interpretojnë ngjarjet ekonomike dhe efektet e tyre

³⁸Мателиевска Маргарита,Паческоски Влатко, (2011). Економија на трговски друштва, Скопје.

financiare në ndërmarrje. Kur ndodhin ngjarje ekonomike, kontabilistët i analizojnë dhe i regjistrojnë ato. Periodikisht, kontabilistët përmbledhin rezultatet e ngjarjeve ekonomike në formën e pasqyrave financiare. Më pas, përdoruesit mbështeten në pasqyrat financiare për marrjen e vendimeve të tyre³⁹.

Pasqyrat financiare janë rezultat i procesit të matjes dhe vlerësimit, i cili bazohet në një sërë parimesh. Nëse çdo kontabilist dhe çdo firmë auditimi përdor një grup të ndryshëm të rregullave të vlerësimit dhe matjes, investitorët do ta kenë më të vështirë të përdorin dhe të krahasojnë pasqyrat e tyre financiare. Për shembull, supozoni të paraqesim evidencën e një aktivi të tillë si makinat në Bilancin e gjendjes. Nëse një kontabilist shënon vlerën e blerjes së makinës me një konto të caktuar, kurse një tjetër të përdorë një konto tjetër. Do të jetë njëlloj si çdo kontabilist të flasë në një gjuhë të ndryshme. Prandaj, kontabilistët kanë rënë dakord të zbatojnë një grup të përbashkët parimesh vlerësimi - domethënë një gjuhë të përbashkët - për paraqitjen e informacionit në pasqyrat financiare⁴⁰.

Pasqyrat financiare ndihmojnë menaxhmentin në vendimmarrje, si për shembull cilat produktet duhet t'i prodhojë dhe t'i shesë. Edhe përdoruesit e jashtëm dhe përdoruesit e brendshëm kanë nevojë për informacionin e marrë nga pasqyrat financiare. Pyetjet themelore për të cilat përdoruesit e informatave financiare kërkojnë përgjigje kur marrin vendime, kanë të bëjnë me imazhin financiar të subjektit ekonomik - sa mirë ka punuar biznesi për një periudhë të caktuar në një datë të caktuar. Përgjigje për këto pyetje mund të marrin përmes një sërë pasqyrash financiare të paraqitura nga kontabilistët.

Shtatë hapa të analizës financiare

1. Qëllimi (përcaktohet se çfarë duhet të bëhet),
2. Identifikimi (i të dhënave relevante nga kontabiliteti),
3. Procesi (vendoset metoda e analizës për menaxhim)
4. Llogaritja (krahasimi material i të dhënave),

³⁹ Charles T. Horring, Gary L. Sandem, John A. Eliot, Donna R. Filbrick, (2010) "Hyrje në Kontabilitetin Financiar", përkthimi i edicionit të nëntë, USA.

⁴⁰ Charles T. Horring, Gary L. Sandem, John A. Eliot, Donna R. Filbrick, (2010) "Hyrje në Kontabilitetin Financiar", përkthimi i edicionit të nëntë, USA.

5. Krahasimi (krahasimi i periudhave),
6. Interpretimi (vlerësohet gjendja) dhe
7. Aksioni – veprimi.

3.1 Raportet financiare te tregtarët individualë

Tregtarët individualë në Republikën e Maqedonisë në fund të vitit kalendarik kanë për obligim t’ia dërgojnë raportet financiare Regjistrisë Qendror.

Së bashku me raportet financiare dërgohet edhe një deklaratë nga personi përgjegjës tregtar individual, i cili jep deklaratë që të gjitha të dhënat e shënuara në llogarinë vjetore janë të vërteta dhe të sakta. Pastaj dërgohet edhe bilanci i të hyrave dhe shpenzimeve dhe bilanci vjetor tatimor.

- **Bilanci i të hyrave dhe shpenzimeve**

A) Të ardhurat dhe shpenzimet nga veprimtaria e pavarur

Të hyrat gjithsej, të hyrat nga shitja e produkteve të gatshme, të hyrat nga shitja e produkteve të lëndëve të para, materialeve dhe mallrave, të hyrat nga shërbimet, shpenzimet totale, kostoja e lëndëve të para të shitura, materialeve dhe mallrave, vlera e energjisë së harxhuar, tatimi mbi vlerën e shtuar i paguar etj.

B) Rezultati financiar

Të hyrat neto para tatimit dhe humbja para tatimit

C) Të dhëna të veçanta

Toka dhe ndërtesat, objekte ndërtimore, pajisjet etj.

- **Bilanci tatimor vjetor**

A) Përcaktimi i bazës për llogaritjen e tatimit mbi të ardhurat neto nga aktiviteti i pavarur
Të hyrat neto para tatimit, Humbja para tatimit, Shpenzimet që nuk njihen për qëllime tatimore, e tj.

B) Lirimet dhe lehtësimet tatimore

Lirime në bazën tatimore, lirimi vjetor tatimor, baza tatimore për llogaritjen e tatimit, tatimi i llogaritur

C) Tatimi për t'u paguar/ kthyer

Tatimi vjetor i llogaritur për t'u paguar, akontacionet e paguara për periudhën tatimore etj.

3.2 Raportet financiare te shoqëritë tregtare

Raportet financiare për shoqëritë tregtare ndahen në 3 grupe, ato janë ⁴¹:

- Treguesit e stabilitetit financiar: siguria financiare, aftësia kredituese, shkalla e vetëfinancimit dhe shkalla e mbulimit të mjeteve jo rrjedhëse.
- Treguesit e likuiditetit financiar, tregues i cili përbëhet nga: likuiditeti rrjedhës, likuiditeti i përgjithshëm, dita e kërkesave të lidhura, dita e stoqeve të lidhura dhe ditët për pagesën e detyrimeve.
- Treguesit e suksesit afarist : fitimi i vitit financiar në raport me të hyrat nga puna e rregullt, fitimi i vitit financiar në raport me gjithë aktivitetin dhe paga mesatare neto për një të punësuar për muaj.

⁴¹ Xhafa Halit, (2005). Drejtimi financiar ndërkombëtar, Tiranë

3.3 Raportet financiare te shoqëritë aksionare

Njëlloj sikur shoqëritë tregtare dhe tregtari individual edhe shoqëritë aksionare kanë obligim në fund të vitit të dërgojnë raport financiar në Regjistrin Qendror. Raporti që e dërgojnë shoqëritë aksionare në RMV përbëhet nga ⁴².

Raporti për gjendjen financiare. Raport i cili në vete përfshin aktivën dhe pasivën.

Aktiva përbëhet nga: patundshmëria në pajisje dhe impiante, mjetet jo materiale, investimi në letra me vlerë, kredi dhe hua të dhëna, kërkesa nga blerësit dhe kërkesa të tjera, kërkesa nga tatimi në fitim, stoqet, avance të dhëna, depozitat në bankë, paratë dhe ekuivalentët e saj.

Pasiva përbëhet nga: kapitali i pronarëve, rezervat, fitimi i akumuluar.

Detyrimet: detyrimet për kredi, rezervimet, detyrimet për tatim në fitim, detyrimet ndaj furnizuesve.

Raporti mbi të ardhurat gjithëpërfshirëse. Realizimi - shpenzimet e realizimit = bruto fitimin.

Të hyrat të tjera - shpenzimet për distribucion dhe shitje - shpenzimet administrative - shpenzimet e tjera = fitimi nga puna e rregullt.

Fitimi para tatimit. Tatimi në fitimi, Fitimi për vitin kalendarik.

Raporti mbi ndryshimet në kapital.

Rritje në vlerën e investimeve në letrat me vlerë të vlefshme për shitje, fitimi për vitin kalendarik, transferimi nga fitimi i akumuluar në rezerva të tjera etj.

Raporti për rrjedhën e parasë. *Flukset monetare nga aktivitetet operative:* Harxhimet e amortizimit për patundshmëri, pajisje dhe impiante; Harxhimet e amortizimit për mjetet jo materiale; Fitimi kapital nga shitja e patundshmërive, pajisjeve dhe impianteve; Dëmtimi i aktiveve fikse; korigjimi i vlerës së aksioneve etj.

Flukset e parasë nga aktivitetet e investimit. Blerje e patundshmërive, pajisjeve dhe impianteve; Blerje e mjeteve jo materiale; Hyrje nga shitja e patundshmërive, pajisjeve dhe impianteve; Depozita të dhëna në bankë, Kamata të pa paguara; Kredi dhe hua të dhëna etj.

⁴² Regjistri Qendror: CRM.com.mk, Llogaritë vjetore

3.4 Llogaria vjetore e shoqërive tregtare në RMV

Përbërja e pasqyrave financiare të përgatitura në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar përmban⁴³ :

Tabela 7. Pasqyrat financiare që duhet dërguar në Regjistrin Qendror të Maqedonisë së Veriut

Pasqyrat financiare që duhet dërguar në Regjistrin Qendror të Maqedonisë				
Bilanci i gjendjes (Pasqyra e pozicionit financiar në fund të periudhës)	Bilanci i suksesit (Pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse për periudhën)	Pasqyra e ndryshimeve në kapital	Raporti i rrjedhës së parasë	Shënime, të cilat mbulojnë një pasqyrë të politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe informacione të tjera sqaruese dhe raporte / rishikime që pritet të lexohen me këto raporte

Bilanci i gjendjes – Raporti për gjendjen financiare

Bilanci i gjendjes përbëhet nga *aktiva* dhe *pasiva* të cilat duhet të jenë të barabarta. Në qoftë se këto të dyja nuk janë të barabarta atëherë kemi ndonjë gabim dhe llogaritet se nuk kemi bilanc. *Aktiva* përmban të gjitha mjetet në dispozicion të subjektit ekonomik (të gjitha ato që janë në pronësi dhe të kontrolluara nga subjekti ekonomik - aktivet rrjedhëse: paratë, inventarët, materialet dhe mjetet qarkulluese ose fikse). Pjesa e dytë, *pasiva*, paraqet burimet e mjeteve (detyrimet afatshkurtra dhe afatgjata).

Me ndihmën e bilancit të gjendjes, subjekti ekonomik është në gjendje të bëjë plane strategjike afatgjata nëse fitimet nga operacioni do të drejtohen drejt zgjerimit të pajisjeve, furnizimit me makina ose pajisje të reja, përmirësimit të shërbimeve etj. Qëllimi i bilancit të

⁴³ Crm.com.mk

gjendjes është që të pasqyron gjendjen financiare (aktivet, detyrimet dhe kapitalin) të një entiteti kontabël në një moment kohe të caktuar⁴⁴.

Bilanci i gjendjes klasifikohet sipas kategorive kryesore të aktiveve, pasiveve dhe kapitalit, dhe llogaritë e mëtejshme grupohen në nën kategori, me qëllim që përdoruesit e pasqyrave financiare të kenë një pasqyrë më të qartë të pozitës financiare të subjektit ekonomik dhe t'i kushtojnë vëmendje llogarive speciale. Bilanci i gjendjes jep informacion rreth aftësisë së subjektit ekonomik për të përmbushur nevojat dhe borxhet operationale afatshkurtra⁴⁵. Investitorët janë më së shumti të interesuar në perceptimin e aftësisë së subjektit ekonomik për të pasur vit financiar në fitim dhe për të paguar dividendë.

Bilanci i suksesit

Bilanci i suksesit paraqet rezultatin financiar të subjektit ekonomik gjatë vitit kalendarik të biznesit, pra është një pasqyrë që tregon të dhëna mbi të ardhurat, shpenzimet dhe rezultatin financiar nga operationet, përkatësisht fitimi ose humbja nga operationet. Ai tregon në detaje të ardhurat dhe shpenzimet që njësi ekonomike realizon gjatë një periudhe të vetme kontabël, e cila zakonisht është një vit. Varësisht nëse të ardhurat janë më të larta se shpenzimet ose anasjelltas, njësi ekonomike gjeneron fitim ose humbje⁴⁶.

Bilanci i suksesit është shumë i rëndësishëm për menaxhimin e subjektit ekonomik, sepse duke analizuar pozicionet individuale të bilancit, menaxherët mund të shohin se në cilat segmente operationesh mund të arrihen rezultate më të mira në periudhën e ardhshme, d.m.th. rritja e të ardhurave të veçanta dhe zvogëlimi i shpenzimeve të ndara nga operationet e subjektit ekonomik. Nëse të hyrat janë më të mëdha se shpenzimet, në bilancin e suksesit paraqitet fitimi dhe e kundërta tregon humbjen - nëse të hyrat janë më të vogla se shpenzimet, në bilancin e suksesit kemi humbje.

⁴⁴ Deari Fitim, (2007). Parimet e kontabilitetit financiar, Tetovë.

⁴⁵ Дрогирска Лорета, (2012) магистерски труд “Ревизија на финансиските извештаи, Комплетирање на ревизорски процес и издавање на конечен ревизорски извештај”.

⁴⁶ Дрогирска Лорета, (2012) магистерски труд “Ревизија на финансиските извештаи, Комплетирање на ревизорски процес и издавање на конечен ревизорски извештај”.

Bilanci i suksesit përmban informacione të rëndësishme që ndihmojnë investitorin gjatë marrjes së vendimit të tij të investimeve, si dhe përdoruesve të tjerë të jashtëm. Nëse pasqyra e të ardhurave tregon një humbje, kjo do të thotë se bashkëpunëtorët do të jenë të kujdesshëm, sidomos në qoftë se subjekti kërkon kredi, është shumë e rëndë, pothuajse e pamundur, t'u jepet kredi subjekteve të tilla.

Në fillim të çdo biznesi, subjekti ekonomik në shumicën e rasteve ka investime fillestare të cilat janë të larta e kanë për qëllim të ndihmojnë për të filluar me punë subjekti dhe si pasojë e kësaj, në vitet e para të operimit të biznesit, subjekti paraqitet me humbje. Por edhe pse del me humbje nuk do të thotë që biznesi nuk është kosto-efektiv për periudhë më afatgjate. Por nëse pas viteve fillestare kur kemi investime, subjekti ekonomik sipas parashikimeve ende po punon me humbje, duhet parashtruar pyetja nëse biznesi është kosto-efektiv dhe rentabil.

Pasqyra e fluksit të parasë

Pasqyra e rrjedhës së parasë jep një pasqyrë të punës së biznesit në një periudhë më të gjatë kohore. "Kompanitë duhet t'i kushtojnë më shumë vëmendje pasqyrës së rrjedhës së parasë. Jo rastësisht, Warren Buffett është investitori më i famshëm miliarder në botë. Kur merr dhe investon në kompani individuale, ai gjithmonë sheh pasqyrën e parasë së gatshme, jo bilancin e gjendjes dhe suksesit, si të gjithë të tjerët"⁴⁷.

Për të kuptuar rrjedhën e parasë së gatshme është e nevojshme të njihni mirë bilancin e gjendjes dhe bilancin e suksesit, pasi ato janë bazë për përgatitjen e pasqyrës së rrjedhës së parasë. Të dhënat bazë që mund të merren nga pasqyra e rrjedhës së parasë janë si më poshtë: rrjedha e parasë, d.m.th. likuiditeti i subjektit ekonomik; sa para ose *cash* janë të nevojshme për aktivitetet e rregullta të subjektit ekonomik; sa para merr një subjekt ekonomik nga operacionet e tij; diferenca midis fitimit dhe parave të gatshme etj.

Pasqyra e rrjedhës së parave shpjegon se nga rrjedhin paratë e subjektit ekonomik dhe ku është shpenzuar për një periudhë kohore. Mjetet monetare të njësisë ekonomike përfshijnë *cash*-in në qarkullim, të holla në llogaritë e bankave dhe ekuivalentët e tyre.

⁴⁷ Димитриска-Кочоска Гордана,(2011). Стопанска Банка, второ издание на "Академија на Капитал", "Капитал", Скопје.

Pasqyra e rrjedhës së parave lejon që investitorët dhe menaxherët të ndiejnë pulsën e qarkullimit të gjakut - në çdo kompani. Pikëpamjet në lidhje me mirëmbajtjen e nivelit të fondeve ndryshojnë. Disa menaxherë dhe investitorë preferojnë sigurinë duke mbajtur sasi të mëdha të parave të gatshme, ndërsa të tjerët minimizojnë paranë e gatshme pasi ato sigurojnë vetëm fitime të vogla për subjektin ekonomik⁴⁸.

Raporti mbi ndryshimin e kapitalit

Për të siguruar informata të plota të nevojshme për procesin e vendimmarrjes, biznesi ka nevojë për raporte të plota, që do të thotë se përveç pasqyrave të tjera financiare duhet të paraqitet edhe raporti mbi ndryshimet në kapital. Raporti mbi ndryshimet në kapital (kapitali) përmban informacionin e mëposhtëm⁴⁹:

- të ardhurat e përgjithshme gjithëpërfshirëse për periudhën, duke treguar veçmas shumat e përgjithshme që i takojnë pronarëve të subjektit ekonomik dhe pjesëmarrjes së pakontrolluar (pronarëve të vegjël të kapitalit),
- për çdo komponent të kapitalit, efektet e zbatimit retrospektiv të ndryshimeve në politikat kontabël ose rregullimi retrospektiv i shumave të njohura sipas SNK 8,
- Ndryshimet në kapitalin neto të subjektit ekonomik midis dy datave të bilancit të gjendjes pasqyrojnë një rritje ose rënie në aktivet neto ose pasuri gjatë periudhës së kontabilitetit, sipas parimeve specifike të matjes, të miratuara dhe të shpalosura në pasqyrat financiare.

Përveç ndryshimeve që rrjedhin nga transaksionet me aksionarët, ndryshimi i kapitalit të përgjithshëm përfaqëson fitimet dhe humbjet totale që rrjedhin nga aktivitetet e subjektit të biznesit gjatë periudhës kontabël.

⁴⁸ Charles T. Horryng, Gary L. Sandem, John A. Eliot, Donna R. Filbrick, (2010) "Hyrje në Kontabilitetin Financiar", përkthimi i edicionit të nëntë, USA.

⁴⁹Николовски Пеце, (2003). Анализа и ревизија на финасиските извештаи на претпријатијата во РМ во функција на економска ефикасност" – Докторска Дисертација, Економски Факултет – Прилеп.

Shënimet, anekset plotësuese të treguesve financiarë për raportet financiare, amortizimi dhe raporte të tjera

Shënimet, anekset plotësuese të treguesve financiarë përfshijnë informacionin për borxhet, detyrimet e kushtëzuara, amortizimin në mënyrë më të detajuar, llogaritë ose informacionin që shpjegojnë rezultatet financiare, të cilat janë paraqitur në pasqyrat financiare dhe dhënien e informacioneve të kërkuara nga SNRF, të cilët nuk janë shpalosur diku tjetër në pasqyrat financiare. Shënimet në pasqyrat financiare janë pjesë përbërëse e grupit të plotë të pasqyrave financiare. Ato përfaqësojnë shënime shtesë dhe informacione dhe i bashkëngjiten pasqyrave financiare për të ofruar informacion më të plotë për përdoruesit e fundit. Shënimet shpjegojnë më mirë mënyrën në të cilën llogariten disa zëra dhe në mënyrë më objektive perceptohet pozicioni financiar i subjektit ekonomik.

Subjektet ekonomike zakonisht i paraqesin shënimet në një urdhër të veçantë në mënyrë që përdoruesit më lehtë të kuptojnë pasqyrat financiare dhe t'i krahasojë ato me pasqyrat financiare të subjekteve të tjera ekonomike:

- Deklarata e përputhshmërisë me SNK;
- Një pasqyrë e politikave të rëndësishme kontabël që zbatohen;
- Elementet shoqëruese për artikujt që janë paraqitur në bilancin e gjendjes, bilancin e suksesit, pasqyrën e rrjedhës së parasë së gatshme, pasqyrën e ndryshimeve në kapital sipas rendit në të cilin paraqiten raportet;
- Informacione shpjeguese të tjera.

4. Përcaktimi i gjendjes ekonomike financiare të shoqërive tregtare në regjionin e Tetovës

Racio analiza konsiderohet si bazë për marrjen e vendimeve racionale të biznesit. Qëllimi i analizës financiare është të përcaktojë sasinë dhe vlerësimin e marrëdhënieve funksionale që ekzistojnë midis pozicioneve të bilancit në mënyrë që të sigurohen informacione të besueshme për pozicionin financiar dhe aktivitetet e subjektit ekonomik⁵⁰. Në të vërtetë, kjo analizë shqyrton marrëdhëniet midis pjesëve të lidhura të pasqyrave financiare, në mënyrë që

⁵⁰ Мателиевска Маргарита, Паческоски Влатко, (2011). Економија на трговски друштва, Скопје.

të nxjerrë në pah dhe shpjegojë marrëdhëniet kyçe që varen nga pozicioni financiar i tanishëm dhe i ardhshëm i subjektit ekonomik. Racio analiza paraqet raport matematikor midis dy madhësive.

Racio analiza është produkt i pasqyrave të ndryshme financiare dhe rëndësia e tij perceptohet kryesisht në përmbledhjen e marrëdhënieve dhe rezultateve kyçe që tregojnë performancën financiare të subjektit⁵¹.

Racio numrat (fjala Racio e ka prejardhjen nga anglishtja që do të thotë marrëdhënie) janë numra që përfaqësojnë një marrëdhënie midis dy pozicioneve të lidhura në mënyrë funksionale. Ato përdoren në analiza të pjesshme financiare.

Përmes analizës së pasqyrave financiare, menaxhmenti financiar mund të identifikojë dobësitë e organizatës, me qëllim që ato ti korrigjojë. Po kështu, edhe kreditorët janë të interesuar të matin gjendjen dhe sigurinë e huave të tyre. Analiza e pasqyrave financiare me anë të përlogaritjes së treguesve mund të jetë një mjet shumë i dobishëm për menaxhmentin për të verifikuar afarizmin vijues të subjektit dhe pozitën e tij në krahasim me konkurrencën. Një analizë e kryqëzuar brenda grupit të subjekteve të njëjta, apo të ngjashme, do të tregojë nëse një subjekt i caktuar po ecën më shpejt apo më ngadalë nga mesatarja e asaj fushe.

Ne kuadër të treguesve financiarë bëjnë pjesë :

1. Treguesit e likuiditetit
2. Treguesit e përdorimit të aktiveve,
3. Treguesit e aftësive paguese,
4. Treguesit e rentabilitetit ROI
5. Treguesit e tregut.

⁵¹ Ivanis M., (2012) "Uvod u korporativne finansije i tehnike upravljanja korporativnim finansijama", Univerzitet Singidunum Beograd, Serbija.

4.1.1 Treguesit e Likuiditetit

Likuiditeti është aftësia e subjektit ekonomik për të shlyer të gjitha detyrimet e tij aktuale (të përditshme) brenda afatit të parashikuar. Në qoftë se një subjekt është likuid, ai do të jetë në gjendje të shlyejë në kohë obligimet e tij. Likuiditeti i subjektit ekonomik është një element i rëndësishëm i rezultateve të tij financiare, sepse ai varet jo vetëm nga marrëdhëniet e mira të biznesit me kreditorët, por gjithashtu edhe nga mbijetesa e tij, sepse subjekti ekonomik që është jo likuid në një periudhë të caktuar kohe është një kandidat serioz për falimentim dhe likuidim⁵².

Analiza e likuiditetit shpesh kërkon një krahasim dinamik të aktiveve afatshkurtra (sidomos të parasë së gatshme) me maturimin e detyrimeve të subjektit muaj për muaj ose edhe ditë pas dite.⁵³

Thelbi i menaxhimit të likuiditetit rrjedh nga fakti që detyrimet e subjektit në kushte normale mund të paguhen vetëm nëpërmjet aktiveve likuide. Likuiditeti i një subjekti ekonomik do të jetë më i madh nëse disponon më shumë fonde nga burimet e veta se sa nga burimet e huaja dhe nëse qoftë se ato janë më shumë të një natyre afatgjate sesa të një natyrë afatshkurtra. Aktivitetet likuide përfshijnë një pjesë të kapitalit punues që mund të përdoren menjëherë ose në një periudhë relativisht të shkurtër për pagesën e detyrimeve afatshkurtra. Këto përfshijnë të holla, kërkesat afatshkurtra dhe plasmanet në letrat me vlerë afatshkurtra.

Për të bërë pagesën e detyrimeve afatshkurtra, paratë e nevojshme sigurohen përmes shitjes ose arkëtimit të kërkesave ose burimeve jashtë procesit të biznesit. Prandaj, racio analiza e likuiditetit duhet të ofrojë një bazë informacioni për t'iu përgjigjur pyetjes:

„Subjekti ekonomik a disponon mjete dhe pasuri të mjaftueshme (të arkëtueshme dhe inventar) që në rrethana normale, relativisht shpejt (para maturimit) të konvertohen në mjete monetare me qëllim të përmbushjes së detyrimeve që duhet të paguajnë? “

Llojet e mëposhtme të raporteve-likuiditete përdoren për analiza statistikore:

⁵² Сашо Арсов, (2008) "Финансиски Менаџмент", Скопје.

⁵³ Zeqiri Izet,(2004). "Menaxhimi Financiar", Tetovë.

Raporti likuiditeti rrjedhës (korent)

Treguesi i likuiditetit rrjedhës është treguesi më i përgjithshëm i likuiditetit të subjektit ekonomik, që tregon aftësinë e subjektit ekonomik për shlyerjen e detyrimeve afatshkurtre (korente).

Detyrimet korente janë detyrime me maturim prej një viti dhe ato mund të shlyhen nga mjetet në dispozicion që do të mund të konvertohen në para në dorë për një periudhë një vjeçare. Raporti rrjedhës është raporti i mjeteve rrjedhëse ndaj detyrimeve rrjedhëse. Ai tregon se sa mire janë mbuluar detyrimet me afat të shkurtër të cilat duhet të paguhen brenda vitit.

$$\text{Likuiditeti rrjedhës (korent)} = \frac{\text{Aktivet (mjetet) rrjedhëse}}{\text{Detyrimet rrjedhëse}}$$

Implikimi analitik : Sa më i lartë raporti korent aq më shumë mundësi ka subjekti të paguajë detyrimet afatshkurtra .

Një raport korent më i vogël se 1 do të thotë që kompania ka kapital qarkullues negativ dhe se është duke kaluar krizë likuiditeti.

Aktivet korente ose qarkulluese zakonisht përfshijnë zërat e arkës, bankës, inventarët, llogaritë e arkëtueshme dhe investimet afatshkurtra.

Detyrimet korente ose afatshkurtra përbëhen nga llogaritë e pagueshme, dëftesa të pranuar, hua bankare, tatime, etj. Nëse detyrimet korente rriten më shpejt se aktivet korente, raporti korent do të ulet dhe kjo do të thotë se ka probleme.

Ky tregues është një tregues për mbrojtjen e kreditorëve afatshkurtër dhe prandaj është e dëshirueshme që subjekti ekonomik të rrisë shkallën e mbulimit të detyrimeve afatshkurtra dhe kështu kërkesat e tyre të jenë subjekt i një rreziku më të ulët të mos arkëtueshmërisë⁵⁴.

⁵⁴ Мацова Виолета,(2010) Модели за проценка на солевнтност на банкарските клиенти, Скопје.

Raporti i likuiditetit të përshpejtuar ose testi Acid

Testi acid (raporti i shpejtë) –është një raport më konservator se Raporti korent pasi në llogaritje nuk përfshihet inventari ose aktive të tjera të cilat nuk janë shumë likuide.

Detyra kryesore e këtij treguesi është të plotësojë imazhin e dhënë nga treguesi i mëparshëm. Pra, qëllimi i këtij treguesi është vlerësimi i mundësisë që subjekti ekonomik të paguajë detyrimet e tij afatshkurtra duke përdorur aktivet më likuide⁵⁵. Domethënë, sipas këtij raporti, sasi të janë marrë, dhe jo vetëm sasi të e vjetruara, por inventarët në përgjithësi, sepse ato nuk përbëjnë një burim likuid fondesh siç janë paratë e gatshme dhe kërkesat. Për shembull, nëse bisedohet për stoqe të materialeve, së pari ata duhet të harxhohen në procesin e prodhimit për të marrë një produkt të gatshëm dhe pastaj duhet të kalojë një kohë shtesë për të shitur stokun e produkteve të gatshme.

$$\text{Testi acid} = \frac{\text{Aktivet rjedhëse} - \text{Inventarët (stoqet)}}{\text{Detyrimet afatshkurta}}$$

Thelbi i këtij treguesi është se ajo duhet të arrijë në një minimum prej 1 ose më shumë, domethënë detyrimet aktuale nuk duhet të jenë më të mëdha se asetet më likuide.

Raporti i likuiditetit monetar

Ky tregues plotëson raportin rrjedhës të likuiditetit dhe raportin aktual të likuiditetit. Ai mat shumën e parave dhe ekuivalentëve të saj në dispozicion për të mbuluar detyrimet aktuale. Ky lloj treguesi llogaritet duke përdorur formulën e mëposhtme:

$$\text{Raporti i likuiditetit monetar} = \frac{\text{Cash}}{\text{Detyrimet afatshkurta}}$$

- Nëse treguesi është më i madh se 1, atëherë njësia ekonomike përkatëse likuidohet në ditën e matjes së likuiditetit.
- Nëse treguesi është i barabartë me 1, atëherë është kufiri minimal nën të cilin nuk duhet të ulet.
- Nëse treguesi është më i ulët se 1, atëherë paraja në dispozicion nuk është e mjaftueshme për të shlyer detyrimet e duhura.

⁵⁵ Xhafa Halit, Ciceri Beshir, (2006). Drejtimi financiar 1 botimi i tretë, Tiranë

4.1.2 Raportet e përdorimit të aktiveve

Grupi tjetër i raporteve, raportet e aktiveve (mjeteve totale), matin efektivitetin e menaxhimit të aktiveve nga shoqëria. Nëse një shoqëri ka shumë aktive, kostoja e kapitalit të saj do të jetë tepër e lartë, si rrjedhim fitimet e saj do të ulen. Në anën tjetër nëse aktivet e saj janë tepër të ulëta, fitimet nga shitja do të ulen. Subjekti investon në kapitalin bazë dhe atë punues për t'i përdorur ato në mënyrë efikase, me më pak investime për të arritur një vëllim më të madh të aktiviteteve afariste.⁵⁶

Më poshtë kemi të paraqitur disa ndarje të raporteve të aktiveve⁵⁷:

Qarkullimi i llogarive të arkëtueshme tregon sa herë arkëtohen mesatarisht gjatë vitit llogaritë e arkëtueshme. Në përgjithësi qarkullimi më i lartë është i mirë. Treguesi i qarkullimit të kërkesave tregon efikasitetin e përdorimit të kredive që kompania i ka dhënë klientëve të saj. Qëllimi i miratimit të kredive të tilla është rritja e shitjeve, ndërsa mungesa është mundësi që klientët të vonojnë detyrimet e kredisë, në kohë dhe në tërësi⁵⁸.

$$\text{Qarkullimi i llogarive të arkëtueshme} = \frac{\text{Shitjet Neto}}{\text{Llogaritë e arkëtueshme (kërkesat)}}$$

Ky tregues na tregon numrin e cikleve gjatë një viti që fillon me shitjen e mallrave me kredi, dhe përfundon me pagesën e tyre, saktësisht sa herë asetet e subjektit që lidhen me arkëtimet shndërrohen në mjete monetare për një vit. Vlera e lartë e këtij treguesi do të thotë se kompania operon në bazë të parave të gatshme ose se kreditë e saj për klientët me mallra dhe mbledhje të arkëtive janë efektive, ndërsa vlera e ulët tregon se kompania nuk menaxhon mirë debitorët dhe ka nevojë të rivlerësojë politikën e saj të biznesit në mënyrë që të sigurohet mbledhja në kohë e kredive të dhëna nga të cilat subjekti nuk fiton interes.

⁵⁶ Горгиева Оливера-Трајковска, (2010). Анализа на финансиски извештаи со осврт на финансиската стабилност на корпоративниот сектор во РМ. Докторски Труд, Скопје

⁵⁷ Xhafa Halit, Ciceri Beshir, (2006). Drejtimi financiar 1 botimi i tretë, Tiranë

⁵⁸ Xhafa Halit, Ciceri Beshir, (2006). Drejtimi financiar 1 botimi i tretë, Tiranë

Koha mesatare e arkëtimit – mat mesatarisht sa kohë i duhet subjektit të arkëtojë llogaritë e arkëtueshme.

$$Koha\ mesatare\ e\ arkëtimit = \frac{365}{Qarkullimi\ i\ llogarive\ të\ arkëtueshme}$$

Ky tregues tregon se sa ditë nevojiten mesatarisht për të rimarrë mallrat e shitura blerësve me kredi.

Qarkullimi i inventarit mat efikasitetin e kompanisë në menaxhimin dhe shitjen e inventarit. Është matës i likuiditetit të inventarit të kompanisë. Ky tregues na tregon sa shpejt kompania përdor inventarin në krijimin e produkteve të gatshme dhe shërbimeve të shitjes.

$$Qarkullimi\ i\ inventarit = \frac{Shitjet\ neto\ (KMSH)}{Inventari}$$

Nëse ky koeficient do të ishte 5, do të thotë se rezervat do të realizohen dhe riprodhohen mesatarisht 5 herë në vit. Ky tregues është shumë i rëndësishëm për të gjitha kompanitë, sepse tregon se cilat produkte kanë prodhim të shpejtë ose sa mirë është shitur një produkt. Nëse e ndajmë numrin e ditëve në vit me koeficientin e qarkullimit të inventarëve, do të fitojmë kohëzgjatjen mesatare të një qarkullimi.

$$Kohëzgjatja\ mesatare\ e\ inventarit = \frac{365}{Koeficienti\ i\ qarkullimit\ të\ inventarit}$$

Kur analizohet ky tregues, duhet të merret parasysh natyra e veprimtarisë në të cilën operon kompania dhe procesi i punës në kompani.

Raporti i qarkullimit të detyrimeve ndaj furnitorëve, Një nga aktivitetet më të rëndësishme të çdo subjekti juridik është, blerja e materialeve dhe shërbimeve për procesin e prodhimit. Nga këto aktivitete lind detyrimi ndaj furnitorëve për blerjen e pagesës së shtyrë. Është shumë e rëndësishme të përcaktohet koha mesatare në të cilën detyrimet e kanë afatin për t'u paguar gjatë vitit dhe kjo kohë merret nga koeficienti i llogaritur i qarkullimit të furnizuesve.

$$Koeficienti\ i\ qarkullimit\ të\ furnitorëve = \frac{Vlera\ vjetore\ e\ furnizimit\ të\ materialeve}{Saldo\ mesatare\ e\ furnitorëve\ gjatë\ vitit}$$

Nëse vlera e këtij raporti do të ishte 5, kjo do të thotë se obligimet ndaj furnizuesve paguhen mesatarisht 5 herë në vit.

Koha mesatare e qarkullimit të llogarive të pagueshme – mat mesatarisht sa kohë i duhet subjektit të paguajë llogaritë e pagueshme (detyrimet).

$$Koha\ mesatare\ e\ pagesës = \frac{365}{Qarkullimi\ i\ llogarive\ të\ pagueshme}$$

Numri i ditëve që merren duke llogaritur koeficientin e mëparshëm tregon kohën mesatare të kthimit.

Raporti i qarkullimit të aktiveve totale. Për të marrë një pasqyrë të përgjithshme të produktivitetit të një kompanie, krahasimi i vlerës së shitjeve të arritura gjatë një periudhe bëhet me asetet totale që kontribuojnë në arritjen e tij.

$$Qarkullimi\ i\ aktiveve\ totale = \frac{Shitjet\ neto}{Totali\ i\ aktiveve}$$

Ky tregues tregon sa herë gjatë vitit asetet e përgjithshme janë konvertuar në shitje. Nëse ky tregues është 2, kjo do të thotë se çdo denar i investuar në totalin e aktiveve gjeneron dy vlera denarë të shitjes.

Treguesi i qarkullimit të aktiveve totale gjithashtu vë në dukje strategjinë e çmimit të një kompanie - kompanitë me kufij të ulët fitimi kanë tendencë të kenë një raport të lartë të qarkullimit dhe anasjelltas, ato me marzhe të larta të fitimit kanë një raport të ulët të qarkullimit.

4.1.3 Raportet e aftësive paguese (solventiteti)

Solventiteti do të thotë aftësia e subjektit për të shlyer shpenzimet e interesit dhe detyrimet afatgjata sipas kontratës brenda afatit të caktuar më parë. Solventitetin mund ta quajmë edhe si siguri financiare afatgjate e subjektit. Si faktorë për atë siguri janë asetet (mjete), d.m.th. vlera dhe struktura e fondeve në dispozicion të kompanisë, struktura e burimeve të financimit ose të kapitalit, rentabiliteti i subjektit d.m.th fuqia e tij e fitimit⁵⁹.

⁵⁹ Stojilković Mladen, Krstić, J.,(2000), Finansijska analiza. Ekonomski fakultet, Nish, Serbia

Treguesit më të rëndësishëm për analizën e solventitetit janë: raporti i mbulimit të mjeteve dhe raporti i burimeve të financimit.

$$\text{Raporti i mbulimit të mjeteve fikse} = \frac{\text{kapitali fiks}}{\text{mjetet fikse}}$$

Mjetet e përhershme paraqesin aktivet afatgjata jo materiale (koncesionet, patentat, licencat, ...), mjete fikse (toka, ndërtesa, pajisje etj.) dhe investimet financiare afatgjata. Vlera e këtij koeficienti është rreth 1 d.m.th. Rreth 100% tregon aftësinë paguese më të favorshme të kompanisë.

$$\text{Raporti i mbulimit të inventarit të kapitalit neto të punës} = \frac{\text{kapitali qarkullues neto}}{\text{detyrimet afatëshkurta}}$$

Kapitali neto i punës përfaqëson pjesë të kapitalit të tij dhe atij të huazuar afatgjatë, të destinuara për financimin e kapitalit qarkullues. Nëse raporti i mbulimit të inventarit të kapitalit qarkullues është negativ, ajo do të thotë që shuma e kapitalit, rezervat afatgjata dhe detyrimet afatgjata janë të pa mjaftueshme për të mbuluar mjetet fikse.

4.1.4 Treguesit e Rentabilitetit ROI

Çdo e ardhur përfaqëson një rritje të aktiveve ose një rënie të detyrimeve, ndërsa shpenzimet paraqesin një rënie në aktivet dhe një rritje të detyrimeve. Dallimi pozitiv midis të ardhurave dhe shpenzimeve të biznesit është fitimi i biznesit që realizohet duke angazhuar aktivet e biznesit që përdoren për kryerjen e aktiviteteve të biznesit. Varësisht nga efikasiteti i përdorimit të aseteve, subjektet ekonomike realizojnë fitim ose humbje.

Qëllimi i çdo subjekti ekonomik është që të maksimizojë fitimet në afat të gjatë dhe qëllimi i ROI është të shohë shkallën e arritjes së qëllimeve të përcaktuara.

ROI-të janë marrëdhënie relative në dy pozicione ku në llogaritje del fitimi. Në këtë mënyrë kemi disa tregues të rëndësishëm të ROI⁶⁰:

⁶⁰ Xhafa Halit, Ciceri Beshir, (2006). Drejtimi financiar 1 botimi i tretë, Tiranë

a) Aftësia për të gjeneruar fitime nga aktivet gjithsej

$$\text{Raporti i kthimit nga aktivet gjithsej} = \frac{\text{Fitimi neto (EBIT)}}{\text{Aktivet gjithsej}}$$

Qëllimi kryesor i subjektit ekonomik është arritja e shkallës më të lartë të fitimit, duke shpenzuar sa më pak mjete. Në bazë të mjeteve të angazhuara, realizohen të ardhura ose fitimi i mundshëm. Nëse të ardhurat janë më të larta se shpenzimet, atëherë kemi fitim.

b) Kthimi nga aktivet

Raporti i fitimit neto mbi aktivet gjithsej mat ROA, pas tatimeve dhe interesave:

$$\text{Kthimi nga aktivet (ROA)} = \frac{\text{Fitimi neto (EAT)}}{\text{Aktivet gjithsej}}$$

Maksimizimi i shkallës së rimbursimit është i mundur nëpërmjet dy varianteve: Rritja e marzhës së fitimit neto / ose rritja e qarkullimit të mjeteve të subjektit.

c) Kthimi nga kapitali vetanak

Kthimi nga kapitali vetanak (ROE) shpreh raportin e fitimit neto mbi kapitalin e vet dhe mat kthimin nga kapitali i vet.

$$\text{Kthimi nga kapitali vetanak (ROE)} = \frac{\text{Fitimi neto (EAT)}}{\text{Kapitali vetanak}}$$

Aksionarët investojnë që të kenë një fitim nga paratë e tyre dhe ky raport u tregon atyre në bazë kontabël sa mirë po shkon investimi i tyre.

Me ndihmën e analizës Dipont që përdoret në menaxhimin financiar, vlerësimet bëhen për subjektet ekonomike në bazë të përcaktimit të marrëdhënies midis raporteve financiare. Analiza Dippon fillon nga norma e kthimit në kapital (ROE) si një nga treguesit e përgjithshëm të performancës së subjekteve ekonomike.

Norma e kthimit të aktiveve totale

$$\text{Norma e kthimit të aktiveve totale} = \frac{\text{Fitimi neto}}{\text{Të hyrat nga shitja x Koeficienti i qarkullimit i të hyrave totale}}$$

(Koeficienti i qarkullimit i të hyrave totale paraqet koeficientin e fitimit neto dhe të mjeteve totale mesatare).

Struktura financiare

Koeficienti i strukturës financiare tregon se si secila njësi monetare e kapitalit të vet i ka angazhuar mjetet qarkulluese dhe afatgjata. Në fakt, ai mat masën në të cilën biznesi mbështetet në burimet e huazuara të financimit (detyrimet afatgjata dhe afatshkurtra).

$$\text{Struktura financiare} = \frac{\text{Koeficienti i aktiveve mesatare të subjektit}}{\text{Kapitali mesatar vetanak}}$$

4.1.5 Raportet e tregut

Në këtë grup raportesh bëjnë pjesë raportet e tregut që lidhin çmimin e aksioneve të shoqërisë me fitimin, me rrjedhjen e arkës dhe vlerën e shpallur për aksionet e saj⁶¹. Këto raporte i japin menaxherëve një tregues të vlerësimit të inventarëve për perofmancën e kaluar të shoqërisë dhe perspektivën e saj në të ardhmen.

Nëse raportet e rentabilitetit, të menaxhimit të aktiveve, të borxhit dhe të likuiditetit janë të kënaqshme, edhe raportet e tregut do të jenë të larta dhe si rrjedhim çmimi i aksioneve pritet të jetë i lartë.

Raporti çmim/fitim për aksion

Raporti çmim/fitim për aksion (P/E) tregon sa të gatshëm janë investitorët të paguajnë për çdo denar të fitimit të deklaruar.

$$\text{Raporti çmim/fitim} = \frac{\text{çmimi për aksion}}{\text{fitimi për aksion}}$$

⁶¹ Khafa Halit, Ciceri Beshir, (2006). Drejtimi financiar 1 botimi i tretë, Tiranë

Raporti çmim /flukse arke për aksion

Në disa industri çmimi i aksioneve është më i lidhur me flukset e arkës se sa me fitimin neto. Si rrjedhim, investitorët zakonisht e shohin raportin çmim /flukse arke për aksion⁶².

$$\text{Raporti çmim/flukse arke për aksion} = \frac{\text{çmimi për aksion}}{\text{flukset e arkës për aksion}}$$

Disa analistë shohin edhe raporte të tjera përveç P/E dhe P/Flukset e arkës, për shembull në varësi të industrisë disa mund të shikojnë në matësin e çmim/shitje, çmim/konsumator ose çmim /EBI2TDA.

Raporti vlerë tregu/ vlerë kontabël për aksion

Raporti çmim i tregut të aksioneve mbi vlerën e tyre kontabël jep një tregues tjetër për konsideratat e investitorëve për shoqërinë.

$$\text{Vlera kontabël për aksion} = \frac{\text{Kapitali i pronarit}}{\text{Aksionet në qarkullim}}$$

Ndërsa kur pjesëtojmë çmimin e tregut për aksion me vlerën kontabël për aksion, gjejmë raportin çmim tregu/ vlerë kontabël.

$$\text{Raporti treg} = \frac{\text{çmimi i tregut për aksion}}{\text{vlera kontabël për aksion}}$$

Nëse një shoqëri ka një kthim të ulët nga aktivet, raporti vlerë tregu/vlerë kontabël e saj është më i ulët se një shoqëri mesatare. Sipas përvojave botërore shoqëritë ajrore që nuk kanë rezultate të mira kohët e fundit e kanë këtë raport tregu nën 10, ndërsa shoqëritë shumë të suksesshme si Microsoft arrijnë përqindje të lartë të kthimit mbi aktivet, duke shkaktuar që vlera e tregut e tyre të tejkalojë atë kontabël.

⁶² Xhafa Halit, Ciceri Beshir, (2006). Drejtimi financiar 1 botimi i tretë, Tiranë

4.2 Kuptimi dhe përkufizimi i nocionit të bonitetit

Prejardhja etimologjike e fjalës bonitet rrjedh nga fjala latine "bonus" që do të thotë i mirë, kurse nënkupton tërësinë e anëve të mira të një subjekti, të cilat e bëjnë borxhli të mirë dhe të sigurt⁶³. Prandaj është mjaft e pranueshme të shpjegohet se boniteti si një kategori ekonomike mbulon pozicionin e përgjithshëm të subjektit, aktivitetin e përgjithshëm, zhvillimin dhe programet e prodhimit, pozicionin solid të tregut, reputacionin e mirë në botën e biznesit, si likuiditetin ashtu edhe aftësinë kreditore. Si nocion përfshin në vete edhe aftësinë kreditore dhe likuiditetin e borxhliut. Në teori ekzistojnë dilema rreth asaj se cilët tregues mund të shprehin më së miri bonitetin e ndërmarrjes. Dilema silllet rreth asaj se analiza e bonitetit të ndërmarrjes duhet të mbështetet vetëm në treguesit të cilët vërtetojnë se fjala është për borxhli të mirë dhe të sigurt apo është e nevojshme që në analizë të përfshihen të gjitha ato elemente dhe faktorë të cilët e determinojnë, por që në të njëjtën kohë edhe e garantojnë soliditetin e përgjithshëm material, solventitetin, reputacionin në botën afariste, pozitën afariste në treg si dhe programe perspektive prodhuese dhe zhvillimore.

Boniteti i subjektit nuk mund të barazohet me likuiditetin e tij. Një subjekt mund të jetë jo likuid në një periudhë të caktuar kohe dhe të ketë një vlerësim pozitiv të bonitetit (aftësisë paguese të tij).

Shumica nuk bëjnë dallim në mes solventitetit dhe bonitetit dhe mendojnë që është e njëjtë gjë. Por Solventiteti nënkupton aftësinë e subjektit ekonomik që në afat të gjatë t'i shlyejë detyrimet e veta, nocioni i boniteti është nocion shumë më i gjerë, kurse solventiteti është vetëm një tregues i bonitetit të subjektit. Kjo do të thotë se çdo vështrim i bonitetit të ndërmarrjes vetëm nga prizmi i mundësisë së shuarjes së obligimeve në afat të gjatë është i gabueshëm, sepse nëse bankieri analizon solventitetin e borxhliut të ardhshëm, ai do të jetë i gatshëm që t'i japë kredi, por jo për shkak të asaj se tash është solvent. Në qoftë se ai do ishte solvent nuk do të kërkonte kredi. Pasi që nuk është, me kërkesën e tij për kredi ka për synim ta bëhet solvent. Në atë kuptim bankierit si kriter i solventitetit do t'i shërbejë niveli i akumulativitetit i cili mund të pritët, kurse kjo do të thotë edhe niveli i rrezikut të arkëtimit të

⁶³ Rexhepi Sejdi, (1998). Boniteti i ndërmarrjeve në kushtet inflatore, Prishtinë

kërkesave. Nga kjo mund të arrijmë në përfundim se bonitetin e ndërmarrjes nuk e përcakton vetëm solventiteti, por edhe një varg treguesish të tjerë internë të subjektit ekonomik, madje edhe eksternë, të rrethit ekonomik.

Si bazë mbështetëse për analizën e bonitetit të subjekteve ekonomike shërbejnë të dhënat të cilat i ofron llogaritja vjetore përmes raporteve të saj në fund të vitit kalendarik, siç janë bilanci i gjendjes dhe i suksesit.

Kur është fjala për faktorët e përgjithshëm të cilët e determinojnë bonitetin e subjektit, duhet theksuar se analiza reale e bonitetit mund të bëhet vetëm në kuadër të ekonomisë së lirë të tregut ku konkurrenca e vendit dhe ajo e jashtme janë katalizatorë të kaheve të zhvillimit, ku impulset prodhuese vijnë nga kërkesa në treg e jo nga produkti, përkatësisht nga konsumatori e jo nga prodhuesi⁶⁴. Boniteti i subjektit ekonomik është një kategori e ndryshueshme dhe varet nga një sërë faktorësh të brendshëm (endogjenë) dhe të jashtëm (ekzogjenë). Faktorët kompleksë që përcaktojnë bonitetin e subjektit ekonomik dhe e karakterizojnë atë si një kategori jashtëzakonisht komplekse dhe dinamike janë: struktura e aseteve dhe burimeve, vëllimi i prodhimit dhe realizimi, mundësia e grumbullimit të kërkesave, organizimi i punës, produktiviteti, ekonomia, kosto-efektiviteti, likuiditeti, mjedisi, lëvizjet e përgjithshme të biznesit, etj.

Nëse e shohim bonitetin në kuptim të ngushtë, ai shpreh aftësinë kreditore dhe të likuiditetit, kurse në kuptimin e gjerë të pozicionit të tij të përgjithshëm, ai shpreh - kushtetutën organizimin, kushtetutën kadrovike dhe financiare, pozicionin e tregut, reputacionin e subjektit, programet e zhvillimit dhe perspektivën e subjektit⁶⁵.

Një ndikim të rëndësishëm të bonitetit të subjekteve ekonomike kanë⁶⁶: cilësia dhe realiteti i programeve të zhvillimit, shkalla e shfrytëzimit të kapaciteteve, niveli i produktivitetit të biznesit, cilësia e programeve të investimeve, zhvillimi i funksioneve të biznesit etj.

Çdo subjekt ekonomik e vlerëson në mënyrë të pavarur bonitetin e partnerit afarist me të cilin ai hyn në marrëdhënie biznesi. Vlerësimi i bonitetit duke zbatuar kriteret e tregut është një vlerësim i rrezikut të kredisë. Suksesi i ndërmarrjes në një ekonomi tregu zakonisht

⁶⁴ Rexhepi Sejdi, (1998). Boniteti i ndërmarrjeve në kushtet inflatore, Prishtinë

⁶⁵ Knezevic Goran, (2009). Analiza Finansiskih izvestaja, Beograd, Serbia.

⁶⁶ Radovanović Radiša, Pejić Lazar, Stanišić Milovan,(1991). Ocena boniteta proizuče, Beograd, Serbia.

përkufizohet si aftësia e tij për të rritur vlerën e aksioneve të mbajtura nga aksionari, i cili është qëllimi i funksionimit të përgjithshëm të entitetit të biznesit.

Strategjia zhvillimore në nivel të ekonomisë nacionale gjithashtu mund të ndikojë në bonitetin e subjektit. Kemi raste kur subjekti ekonomik mund të ndodhet në një grup të subjekteve, prodhimet e të cilit janë të favorizuara, destinimi i prodhimeve të të cilit është me interes të përgjithshëm, atëherë nga kjo vijmë në rezultatin e bonitetit të subjektit në fjalë, që do të jetë më i lartë për shkallën e sigurisë së kreditimit të prodhimtarisë, pastaj për shkallën e beneficioneve të ndryshme, siç janë tatimet e taksat e ndryshme nga të cilat prodhimi në fjalë është i liruar.

Pozita monopoliste e ndërmarrjes në treg, kur prodhohet për konsumatorë të njohur dhe të sigurt, ndikon në lartësinë e shkallës së bonitetit të ndërmarrjes⁶⁷. Në këtë rast shkalla e rrezikut të mbetjes së prodhimeve në depo është minimale, kurse shkalla e arkëtueshmërisë së prodhimeve të plasura është maksimale, meqenëse ndërmarrja është në pozitë që ta zgjedhë partnerin afarist. Në mesin e faktorëve makroekonomikë, të cilët e definojnë dhe e determinojnë bonitetin e ndërmarrjes, duhet përmendur në mënyrë të veçantë veprimin e inflacionit. Cilësia themelore e inflacionit është shprehje komplekse e gjendjes së një ekonomie nacionale, ai në mënyrë komplekse reflektohet edhe në bonitetin e ndërmarrjeve individuale. Një mënyrë e reflektimit të inflacionit në bonitetin e ndërmarrjes është kjo si për shembull në rrethanat e inflacionit zakonisht bëhet rritja e çmimeve, efekt ky që reflektohet në zhvlerësimin e njësisë monetare. Rrjedhimisht ndërmarrja, pasi mund të ndodhet në pozitën e borxhliut, do të ketë humbje përkatësisht fitime inflatore. Boniteti i ndërmarrjes bie edhe si pasojë e arkëtimit me vonesë të kërkesave nga blerësit, sidomos nëse vlera e atyre kërkesave nuk është ruajtur përmes kontratave të ndryshme.

Arsyet për t'u vështruar boniteti i subjektit sipas konceptit të gjerë janë të shumtë. Sipas këtij koncepti boniteti i subjektit vështrohet si kategori ekonomike dhe llogaritare tejet komplekse, e cila përfshin në vete pozitën e tërësishme të subjektit në rrethin ekonomik dhe shoqëror.

⁶⁷ Rexhepi Sejdi, (1998). Boniteti i ndërmarrjeve në kushtet inflatore, Prishtinë

Qasja sipas konceptit të ngushtë të bonitetit të subjektit nuk nënkupton analizën e të gjitha funksioneve afariste. Ajo kryesisht mbështetet në të dhënat llogaritare dhe raportet afariste të cilat i përpunon llogaritaria.

Më poshtë do të shohim analizën e bonitetit të subjektit ekonomik nga disa pozita të ndryshme⁶⁸:

Analiza e bonitetit të subjektit nga pozita e kredithënësit

Për analizën e shkallës së aftësisë kreditore të subjektit janë të interesuara në radhë të parë bankat dhe institucionet e tjera financiare, të cilat duke qenë në pozitën e kreditorëve, huadhënësve ose pronarëve të aksioneve ose letrave të tjera me vlerë, dëshirojnë të dinë se çfarë është aftësia e ndërmarrjes borxhli në shuarjen e obligimeve, përkatësisht çfarë është boniteti i saj. Për kredithënësin është me rëndësi njohja e likuiditetit rrjedhës dhe të atij perspektiv si dhe rentabilitetit ekzistues dhe ai perspektiv i borxhliut. Shkalla e lartë e rentabilitetit është treguesi më i mirë i bonitetit të ndërmarrjes vështruar nga pozita e kredithënësit, duke qenë se ai përmes atij treguesi e sheh sigurimin e kthimit të mjeteve të veta të plasura si dhe arkëtimin e kamatës përkatëse. Mirëpo ndonëse shkalla e rentabilitetit tregon shkallën e shtimit të gjithë kapitalit të ndërmarrjes, ajo megjithatë nuk është garanci se kredithënësi do të mund t'i arkëtojë kërkesat e veta në afatin e përshkruar me kontratën për kreditim. Një gjë e tillë varet në radhë të parë nga struktura dhe afatet e arritjes për pagesë të burimeve të mjeteve si dhe nga struktura dhe afatshmëria e angazhimeve të mjeteve.

Analiza e bonitetit të subjektit nga aspekti i aksionarit

Analiza financiare e afarizmit të ndërmarrjes në periudhën e kaluar, analiza e pozitës së tashme financiare si dhe perspektivat e saj në të ardhmen janë me rëndësi, si për aksionarët e tashëm të subjektit ashtu edhe për aksionarët e ardhshëm potencialë. Aksionarët ekzistues të kapitalit të subjektit ekonomik janë të interesuar para së gjithash për stabilitetin dhe sigurinë e kapitalit të tyre të angazhuar, i cili është i lidhur me stabilitetin e afarizmit të ndërmarrjes në tërësi si dhe me stabilitetin e rezultatit financiar të realizuar. Kur është fjala për bonitetin e subjektit nga ana e aksionarit, duhet pasur parasysh faktin se poseduesi i kapitalit monetar me

⁶⁸ Rexhepi Sejdi, (1998). Boniteti i ndërmarrjeve në kushtet inflatore, Prishtinë

blerjen e fletaksionit fiton të drejtën e pjesëmarrjes në fitim përmes devidendës dhe të drejta të tjera të pjesëmarrjes në qeverisje me tërë kapitalin e ndërmarrjes. Mirëpo, ndërmarrja poseduese e kapitalit financiar ndodhet para dy mundësive kryesore që kapitalin ta plasojë në bankë me rrezik më të vogël, por me shkallë të profitit më të vogël, ose atë ta plasojë në blerjen e fletaksioneve, ku do të realizojë shkallë më të lartë të profitit, por me shkallë të lartë të rrezikut.

Analiza e bonitetit të subjektit nga aspekti i furnitorëve për mall dhe shërbime

Analiza e bonitetit të subjektit nga aspekti i furnitorëve është thujse e njëjtë me atë të kredihënësit. Siguria e arkëtimit të kërkesave të tyre varet nga pozita e përgjithshme financiare e ndërmarrjes dhe nga shkalla e rentabilitetit të saj. Në këtë mënyrë furnitorët janë të detyruar që me qëllim të rritjes së sigurisë së arkëtimit të kërkesave të veta, para se të plasojnë mallin a shërbimet, të bëjnë analizën e bonitetit të ndërmarrjes, e cila në esencë përfshin çmuarjen e të gjithë treguesve relevantë të rentabilitetit. Për furnitorët informatë me rëndësi është se çfarë raporti ka pasur ndërmarrja deri në periudhën e tashme ndaj furnitorëve të tjerë, sidomos ndaj furnitorëve kryesorë. Rëndësi të veçantë ka sidomos analiza e afatit kohor të shuarjes së obligimeve ndaj furnitorëve. Informata të dobishme mund të fitohen edhe përmes analizës së kohës mesatare të arritjes së obligimeve ndaj furnitorëve përmes shfrytëzimit të të dhënave nga bilanci i gjendjes.

Analiza e bonitetit të subjektit nga aspekti i blerësit

Stabiliteti i afarizmit të subjektit varet edhe nga stabiliteti i partnerëve afaristë. Në këtë mënyrë blerësi potencial, i cili është i interesuar në radhë të parë për stabilitetin e vet, do të ndiejë nevojë për analizën e bonitetit të subjektit me të cilën dëshiron të ketë marrëdhënie të shëndosha afariste. Ndërrimi i shpeshtë i partnerëve afaristë, qoftë në rastin e furnizimit apo edhe në rastin e shitjes, mund të reflektohet në jostabilitetin e afarizmit të gjithsejtë të ndërmarrjes. Ndërrimi i partnerëve afaristë më së tepërmi reflektohet në periudhat e krizave ekonomike si dhe në periudhat e kërkesës së shtuar për realitetet përkatëse, kur mosekzistimi i furnitorit permanent do të reflektohet në ngecjen në furnizim ose në furnizimin me çmime të larta të cilat kanë pasojë rënien e shkallës së tërësishme të rentabilitetit të ndërmarrjes.

Mirëpo, për blerësin do të jetë me rëndësi edhe njohja e raportit afarist të ndërmarrjes ndaj blerësve ekzistues si dhe disiplina afariste me rastin e dërgimit të porosive afariste. Mosdërgimi me kohë i porosive të blerësve e dobëson bonitetin afarist të subjektit, duke qenë se blerësve do t'u shkaktohen ngecje në proceset e tyre afariste, me çka do të ulet edhe boniteti i subjektit blerëse.

4.2 Metodologjia e përlllogaritjes së BONITETIT – gjendja ekonomike financiare e SHT sipas Regjistrin Qendror të RMV

Përlllogaritja e bonitetit dhe e analizave financiare, nxjerrja e dokumentacioneve për tenderim e të tjera, në mënyrë zyrtare në RMV e që pranohen në çdo institucion, bëhen në Regjistrin Qendror të RMV. Për të përcaktuar bonitetin e një subjekti në RMV duhet të dorëzojmë kërkesë zyrtare në Regjistrin Qendror të RMV dhe të bëjmë pagesë prej 1.750 denarë, pastaj pas disa ditëve, zakonisht 2 ditë pune, mund ta marrim Bonitetin e punuar për subjektin, për të cilin kemi aplikuar.

Kemi disa indikatorë për vlerësimin e bonitetit të subjektit ekonomik nga ku mund të marrim të dhënat për të cilët jemi të interesuar. Ato ndahen në tri pjesë kryesore :

1. Treguesit e stabilitetit financiar
2. Treguesit e likuiditetit financiar dhe
3. Treguesit e suksesit afarist.

Më poshtë këto tregues mund ti shohim në tabela të veçanta, ku mund të shohim edhe çfarë indikatorit përmban secila prej tyre në brendësi. Së pari do ta paraqesim tabelën e parë ku do të pasqyrohen Treguesit e stabilitetit financiar. Nëse i llogaritim të gjithë treguesit me 100 pikë, sa ka total ponderi i bonitetit, ponderi i Treguesve të stabilitetit financiar merr pjesë me 40 pikë në përcaktimin e bonitetit të subjektit.⁶⁹

⁶⁹ Mazllami Jeton, (2018): Ligjëratat e autorizuara “Financa për menaxher”, FBE, SEEU, Tetovë.

Tabela 8. TREGUESIT E STABILITETIT FINANCIAR - (A/B)

TREGUESIT E STABILITETIT FINANCIAR - (A/B)	Vlera	Ponderi (pesha)	Vlera Optimale	Koeficienti i vlerësimit
SIGURIA FINANCIARE	TSF1	15	50	Nëse $TSF1 > 50$ atëherë do shënojmë koef=ponder=15 Nëse $TSF1 < 50$ atëherë koef=(TSF1/50)*15
AFTËSIA KREDITUESE	TSF2	10	100	Nëse $TSF2 > 100$ atëherë do shënojmë koef=ponder=10 Nëse $TSF2 < 50$ atëherë koef=(TSF2/100)*10
SHKALLA E VETËFINANCIMIT	TSF3	10	50	Nëse $TSF3 > 50$ atëherë do shënojmë koef=ponder=10 Nëse $TSF3 < 50$ atëherë koef=(TSF3/50)*10
SHKALLA E MBULIMIT TË MJETEVE JORRJEDHËSE (në %)	TSF4	5	50	Nëse $TSF4 > 50$ atëherë do shënojmë koef=ponder=5 Nëse $TSF4 < 50$ atëherë koef=(TSF4/50)*5
SHUMA		40		40

Burimi: Jeton, Mazllami. (2018): Ligjeratat e autorizuara “Financa për menaxher”, FBE, Seeu, Tetovë.

Treguesi i likuiditetit financiar përbëhet nga 5 indikatorë për të na dhënë rezultatin që na duhet, mirëpo prapë edhe ky indikator na jep gjithsej 40 pikë ponderi nga gjithsej 100 pikë.

Tabela 9. TREGUESIT E LIKUIDITETIT FINANCIAR - (A/B)

TREGUESIT E LIKUIDITETIT FINANCIAR - (A/B)	Vlera	Ponderi (pesha)	Vlera Optimale	Koeficienti i vlerësimit
LIKUIDITETI RRJEDHËS	TLF1	15	100	Nëse $TLF1 > 100$ atëherë do shënojmë koef=ponder=15 Nëse $TLF1 < 100$ atëherë koef=(TLF1/100)*15
LIKUIDITETI PERGJITHSHËM	TLF2	10	200	Nëse $TLF2 > 200$ atëherë do shënojmë koef=ponder=10 Nëse $TLF2 < 200$ atëherë koef=(TLF2/200)*10
DITET E KËRKESAVE TË LIDHURA	TLF3	5	30	Nëse $TLF3 < 30$ (e lejuar gjer më120) atëherë do shënojmë koef=ponder=5 Nëse $TLF3 > 120$ atëherë koef=(120/TLF3)*5
DITET E STOQEVË TË LIDHURA	TLF4	5	60	Nëse $TLF4 < 60$ (e lejuar gjer më120) atëherë do shënojmë koef=ponder=5 Nëse $TLF4 > 120$ atëherë koef=(120/TLF4)*5
DITET PËR PAGESËN E DETYRIMEVE	TLF5	5	30	Nëse $TLF5 < 30$ (e lejuar gjer më120) atëherë do shënojmë koef=ponder=5 Nëse $TLF5 > 120$ atëherë

			koef=(120/TLF5)*5
SHUMA	40		40

Burimi: Jeton, Mazllami. (2018): Ligjëratat e autorizuara “Financa për menaxher”, FBE, SEEU, Tetovë.

Dhe së fundmi në tabelën e fundit kemi të paraqitur treguesit e suksesit afarist që përbëhet nga më pak indikatorë në krahasim me dy treguesit më lart dhe ndikon edhe me më pak pikë. Nga gjithsej 100 pikë ponderi sa kishte gjithsej ky tregues, ka 20 pikë ponderi në total.

Tabela 10. TREGUESIT E SUKSESIT TË SUBJEKTIT

TREGUESIT E SUKSEIT TË SUBJEKTIT	Vlera	Ponderi (pesha)	Vlera Optimale	Koeficienti i vlerësimit
FITIMI I VITIT FINANCIAR në raport me GJITHSEJ AKTIVIN (ROI) (në %)	TSA1	10	5.5	Nëse $TSA1 > 5.5$ atëherë do shënojmë koef=ponder=10 Nëse $TSA1 < 5.5$ atëherë koef=(TSA1/5.5)*10
FITIMI I VITIT FINANCIAR në raport me TË HYRAT NGA PUNA E RREGULLT (në %)	TSA2	5	6.9	Nëse $TSA2 > 6.9$ atëherë do shënojmë koef=ponder=5 Nëse $TSA2 < 6.9$ atëherë koef=(TSA2/6.9)*5
PAGA MESATARE NETO për të punësuar për muaj (në denarë)	TSA3	5	16209 //	Nëse $TSA3 > 16.209$ / atëherë do shënojmë koef=ponder=5 Nëse $TSA3 < 16.209$ // atëherë koef=(TSA3/16.209)*5
SHUMA		20		20

Burimi: Jeton, Mazllami. (2018): Ligjëratat e autorizuara “Financa për menaxher”, FBE, SEEU, Tetovë.

4.3 Përshkrimi i mostrës së zgjedhur për komunën e Tetovës me komunat rurale

Rezultatet e fituara nga subjektet në komunën e Tetovës dhe komunat e saj rurale, ku kemi bërë hulumtim për subjektet prodhuese, tregtare dhe shërbyese do të përshkruhen në vijim.

Si subjekte për të cilat kemi zgjedhur të bëjmë analizë në këtë temë masteri janë: subjektet prodhuese, subjektet tregtare dhe subjektet shërbyese. Nga numri i përgjithshëm i subjekteve aktive në komunën e lartpërmendur, kërkesës sonë për të marrë të dhëna nga

Ilogaritë vjetore që dorëzohen në Regjistrin Qendror, pozitivisht iu përgjigjën 65 sosh. Do me thënë mostra e zgjedhur e hulumtimit do të bazohet në 65 subjekte ekonomike aktive të ndara në mikro, subjekte të vogla dhe të mesme. Gjatë marrjes së të dhënave kemi hasur në vështirësi, në kuptimin e mundësisë për të bërë hulumtim për një numër më të madh subjektsh, në mënyrë që të zgjerohej hulumtimi edhe më tepër. Ishim të limituar në këtë, për shkak se pronarët e subjekteve nuk pajtoheshin t'i japin të dhënat.

Struktura e shoqërive tregtare sipas madhësisë, në komunën e Tetovës dhe komunat e saj rurale do të paraqitet në vazhdim.

Tabela 11. Struktura e SHT sipas madhësisë, në Tetovë dhe komunat e saj rural, 2016-2017.

	2017					2016				
	Mikro	E vogël	E mesme	E madhe	Gjithsej	Mikro	E vogël	E mesme	E madhe	Gjithsej
Bogovinë	314	82	4	-	400	312	82	3	-	397
Bërvenicë	217	59	4	-	280	237	54	2	-	293
Zhelinë	209	73	4	1	287	205	69	1	1	276
Jegunovcë	143	36	2	1	182	139	36	2	1	178
Tearcë	323	59	2	-	384	294	57	1	-	352
Tetovë	2651	795	25	9	3480	2630	771	22	7	3430
Gjithsej	3857	1104	41	11	5013	3817	1069	31	9	4926

Burimi: Enti Shtetëror i Statistikës

Nga tabela nr.11 mund të shohim që në komunën e Tetovës dhe komunat e saj rurale kemi rritje të numrit të subjekteve ekonomike prej 4.926 në 5.013 subjekte.

Në këtë temë masteri objekt analize kanë qenë subjektet ekonomike nga rajoni i Tetovës dhe komunat përreth saj. Ne kemi bërë kërkesë te një numër më i madh i subjekteve që të bëjmë një analizë sa më të gjerë, por kërkesës sonë i janë përgjigjur pozitivisht 65 subjekte ekonomike për të bërë analizë të bonitetit të tyre. Subjektet që i kemi analizuar për të shtjelluar këtë temë të magistraturës, mund t'i shohim në tabelën e më poshtme Tabela nr.12. Aty subjektet janë të ndara sipas madhësisë: Mikro subjekte janë 17, të vogla janë 47, numri i

subjekteve të mesme ishte më i vogël, madje edhe për ato që ekzistojnë pronarët nuk pajtohen t'i japin të dhënat. Prandaj kemi arritur të përfshijmë vetëm 1 subjekt të tillë.

Tabela 12 Subjektet ekonomike të analizuara në komunën e Tetovës dhe komunat rurale


Komunat	Periudha kohore 2017/2016				
	Mikro	E vogël	E mesme	E madhe	Gjithsej
Bogovinë	3	9	-	-	12
Bërvenicë	1	2	-	-	3
Zhelinë	2	4	-	-	6
Jegunovcë	1	2	-	-	3
Tearcë	2	6	-	-	8
Tetovë	8	24	1	-	33
Gjithsej	17	47	1	0	65

Burimi: Enti Shtetëror i Statistikës RM.

Nga subjektet ekonomike të lartpërmendura të cilat janë 65, ne kemi bërë analizë për subjektet: prodhuese, shërbyese dhe tregtare. Për fillim, më poshtë kemi dhënë një grafikun për të paraqitur numrin e subjekteve prodhuese dhe kemi bërë analizën e bonitetit të këtyre subjekteve.


Vazhdojmë me prezantimin e subjekteve ekonomike sipas veprimtarisë:

Grafiku 1. Subjektet prodhuese me fitim




Si fillim te **Grafikun nr.1** kemi paraqitur rezultatet e subjekteve prodhuese për vitin 2017 dhe 2016 ku kemi analizë vetëm për subjektet me fitim, sepse për subjektet që paraqesin punë me humbje nuk e shohim të arsyeshme të bëjmë analizë. Numri i subjekteve është 20.

Grafiku 1. Treguesit e stabilitetit financiar te subjektet prodhuese me fitim 2016-2017




Në **Grafikun nr.2** kemi të dhëna për **treguesit e stabilitetit financiar** për vitin 2017 ku nga gjithsej 40 pikë të ponderit ne kemi një mesatare prej 36.4 pikë ponderi. Ndërsa te treguesit e stabilitetit financiar për vitin 2016 nga gjithsej 40 pikë të ponderit, kemi një mesatare prej 36.6 pikë.

Grafiku 2. Treguesit e likuiditetit financiar te subjektet prodhuese me fitim, 2016-2017



Gjithashtu në **Grafikun nr.3** i kemi të paraqitura për të dy vitet 2017 dhe 2016 **treguesit e likuiditetit financiar**. Në vitin 2017 nga gjithsej 40 pikë të ponderit, kemi një mesatare prej 34.7 pikë, ndërsa në vitin 2016 kemi mesatare prej 39.3 pikë.

Grafiku 3. Treguesit e suksesit afarist te subjektet prodhuese me fitim, 2016-2017



Si indikator i tretë në **Grafikun nr.4** na paraqitet **treguesi i suksesit afarist** që plotëson pjesën tjetër të ngelur prej 20 pikë. Në analizën tonë për vitin 2017 nga gjithsej 20 pikë të ponderit, kemi një mesatare prej 18.8 pikë, kurse për v. 2016 kemi mesatare prej 18.7.

Tabela 13. Boniteti i subjekteve prodhuese me fitim për vitin 2017 dhe 2016


Indikatorët për vlersimin e bonitetit	Ponderi	2017	2016
TREGUESIT E STABILITETIT FINANCIAR	40	36.4	36.6
TREGUESIT E LIKUIDITETIT FINANCIAR	40	34.7	39.3
TREGUESIT E SUKSESIT AFARIST	20	17.7	17.7
GHITHSEJ BONITETI	100	88.8	93.6

Burimi i të dhënave nga llogaria vjetore në crm 2016-17

Nga e gjithë kjo në **Tabelën nr.13** vijmë në përfundim që për vitin 2017 nga 100 pikë maksimale të indikatorëve për vlerësimin e bonitetit fitojmë 88.8 pikë dhe për v. 2016 kemi 93.6, me çka, në bazë të analizës që kemi bërë, mund të konstatojmë që viti 2016 ka qenë më i suksesshëm për subjektet afariste prodhuese të Pollogut.


Në vazhdim do të analizohen subjektet afariste me veprimtari shërbyese në regjionin e Tetovës. Në këtë drejtim do të analizojmë bonitetin e subjekteve shërbyese me fitim dhe humbje në fund të vitit kontabël.

Grafiku 4 . Subjektet shërbyese me fitim




Nga subjektet shërbyese me fitim në mostrën tone janë përfshirë 20 subjekte sipas madhësive të ndryshme shiko **Grafikun nr.5**.

Grafiku 5. Treguesit e stabilitetit financiar te subjektet shërbyese me fitim




Njëlloj si në paraqitjen e mesatares për subjektet prodhuese, edhe te subjektet shërbyese me fitim në fillim kemi **Grafikun nr.6** ku kemi të paraqitur **treguesit e stabilitetit financiar**. Për vitin 2017 nga gjithsej 40 pikë të ponderit ne kemi një mesatare prej 38.1 pikë dhe për v. 2016 kemi 37.3 pikë.

Grafiku 6. Treguesit e likuiditetit financiar te subjektet shërbyese me fitim



Treguesit e likuiditetit financiar i kemi të paraqitur te **Grafiku nr.7** dhe te subjektet shërbyese me fitim i kemi të paraqitura për të dy vitet 2017 dhe 2016, në vitin 2017 nga gjithsej 40 pikë të ponderit, kemi një mesatare prej 36.1 pikë, ndërsa në vitin 2016 kemi mesatare prej 38 pikë.

Grafiku 7. Treguesit e suksesit afarist te Subjektet shërbyese me fitim



Në **Grafikun nr.8** e kemi Indikatorin e tretë - **treguesi i suksesit afarist**. Në analizën tonë për vitin 2017 nga gjithsej 20 pikë të ponderit, kemi një mesatare prej 17.8 pikë, për v. 2016 kemi mesatare prej 18 pikë.

Tabela 14. Boniteti i subjekteve shërbyese me fitim për vitin 2017 dhe 2016

Indikatorët për vlerësimin e bonitetit	Ponderi	2017	2016
TREGUESIT E STABILITETIT FINANCIAR	40	38.1	37.3
TREGUESIT E LIKUIDITETIT FINANCIAR	40	36.1	38
TREGUESIT E SUKSESIT AFARIST	20	17.8	18
GJITHSEJ BONITETI	100	91.9	93.3


Burimi - te dhënat nga llogaria vjetore ne CRM 2016-17

Në **Tabelën nr.14** kemi të paraqitur **Bonitetin e subjekteve shërbyese me fitim për vitin 2017 dhe v. 2016**. Nga e gjithë kjo vijmë në përfundim që për vitin 2017 nga 100 pikë maksimale të indikatorëve për vlerësimin e bonitetit fitojmë total 91.9 pikë dhe për v. 2016 kemi 93.3. Dhe prapë kemi vitin 2016 më të suksesshëm se v. 2017, pra kemi rezultat të njëjtë siç na doli edhe te subjektet prodhuese.


Analiza e subjekteve shërbyese me humbje

Në **Grafikun nr.9** kemi paraqitjen e subjekteve shërbyese me humbje për vitin 2017 dhe 2016, ku kemi një numër total prej 4 subjekte. Për këto 4 subjekte që kemi pasur informacione vazhdojmë me analizën financiare.

Grafiku 8. Subjektet shërbyese me humbje




Grafiku 9. Treguesit e stabilitetit financiar te subjektet shërbyese me humbje




Në **Grafikun nr.10** janë subjektet shërbyese me humbje dhe **treguesit e stabilitetit financiar** për vitin 2017. Nga gjithsej 40 pikë të ponderit na japin një mesatare prej 29.6 pikë dhe për v. 2016 kemi 30.3 pikë.

Grafiku 10. Treguesit e likuiditetit financiar te subjektet shërbyese me humbje



Treguesit e likuiditetit financiar të paraqitura në **Grafikun nr.11** te subjektet shërbyese me humbje, në analizën e bërë nga subjektet që i kemi marrë si bazë për mesatare në vitin 2017, nga gjithsej 40 pikë të ponderit, kemi një mesatare prej 35.6 pikë, ndërsa në vitin 2016 kemi mesatare prej 37.1 pikë.

Grafiku 11. Treguesit e suksesit afarist te subjektet shërbyese me humbje



Në **Grafikun nr.12** kemi indikatorin e tretë - **treguesi i suksesit afarist**. Sipas analizës sonë për vitin 2017 nga gjithsej 20 pikë të ponderit, kemi një mesatare prej 2.5 pikë, për v. 2016 kemi mesatare prej 2.5 pikë.

Tabela 15. Boniteti i subjekteve shërbyese me humbje për vitin 2017 dhe 2016

Indikatorët për vlerësimin e bonitetit	Ponderi	2017	2016
TREGUESIT E STABILITETIT FINANCIAR	40	29.6	30.3
TREGUESIT E LIKUIDITETIT FINANCIAR	40	35.6	37.1
TREGUESIT E SUKSESIT AFARIST	20	2.5	2.5
GHITHSEJ BONITETI	100	67.6	69.9


Burimi: të dhënat nga llogaria vjetore në crm , 2016-17

Si rezultat i analizës së bërë për **subjektet shërbyese me humbje** në tabelën **nr.15** kemi këtë rezultat: për vitin 2017 nga 100 pikë maksimale të indikatorëve për vlerësimin e bonitetit fitojmë total 67.6 pikë dhe për v. 2016 kemi 69.9 pikë.

Prapë kemi vitin 2016 më të suksesshëm se v. 2017, rezultatit e njëjtë që na doli edhe tek analizat e tjera që na lë të kuptojmë se, në bazë të bilanceve të paraqitura në Regjistrin Qendror, subjektet ekonomike vitin 2016 e kanë pasur më të suksesshëm se v. 2017.


Analiza vazhdon për subjektet tregtare me humbje dhe me fitim. Në fillim do të analizojmë subjektet tregtare me fitim.

Grafiku 12. Subjektet tregtare me fitim




Subjektet tregtare me fitim janë të paraqitura në **Grafikun nr.13**, ku numri i përgjithshëm i subjekteve është 12, prej të cilave 11 janë subjekte të vogla dhe 1 është mikro subjekt.

Grafiku 13. Treguesit e stabilitetit financiar te subjektet tregtare me fitim




Në **Grafikun nr.14** subjektet tregtare me fitim kemi **treguesit e stabilitetit financiar**. Për vitin 2017 nga gjithsej 40 pikë të ponderit, kemi një mesatare prej 29.3 pikë dhe për v. 2016 kemi 29.2 pikë.

Grafiku 14. Treguesit e likuiditetit financiar te subjektet tregtare me fitim



Treguesit e likuiditetit financiar te subjektet tregtare me fitim i kemi në **Grafikun nr.15**. Në analizën e bërë nga subjektet që i kemi marrë si bazë në vitin 2017, nga gjithsej 40 pikë të ponderit kemi një mesatare prej 21.1 pikë, ndërsa në vitin 2016 kemi mesatare prej 24.8 pikë.

Grafiku 15. Treguesit e suksesit afarist te subjektet tregtare me fitim



Treguesit e suksesit afarist janë paraqitur në **Grafikun nr.16**. Në analizën tonë për subjektet tregtare me fitim për vitin 2017 nga gjithsej 20 pikë të ponderit, kemi një mesatare prej 17.6 pikë, për v. 2016 kemi mesatare prej 17.7 pikë.

Tabela 16. Boniteti i subjekteve tregtare me fitim për vitin 2017 dhe v. 2016

Indikatorët për vlerësimin e bonitetit	Ponderi	2017	2016
TREGUESIT E STABILITETIT FINANCIAR	40	29.3	29.2
TREGUESIT E LIKUIDITETIT FINANCIAR	40	21.1	24.8
TREGUESIT E SUKSESIT AFARIST	20	17.6	17.7
GHITHSEJ BONITETI	100	68.0	71.7


Burimi: të dhënat nga llogaria vjetore në crm 2016-17

Si rezultat i analizës së bërë për subjektet tregtare me fitim në **Tabelën nr. 16** kemi këtë rezultat: për vitin 2017 nga 100 pikë maksimale të indikatorëve për vlerësimin e bonitetit fitojmë total 68 pikë dhe për v. 2016 kemi 71.7 pikë.

Në vazhdim do pasojë analiza financiare e subjektet tregtare me humbje.


Bazuar në **Grafikun nr.17** mund të shohim që kemi 9 subjekte tregtare me humbje të paraqitura. Nga to 4 janë mikro subjekte dhe 5 janë subjekte të vogla.

Grafiku 16. Subjektet tregtare me humbje




Tek subjektet tregtare me humbje në **Grafikun nr.18** kemi **treguesit e stabilitetit financiar**. Për vitin 2017 nga gjithsej 40 pikë të ponderit, kemi një mesatare prej 0 pikë ponderi dhe për v. 2016 kemi gjithashtu 0 pikë ponderi.

Grafiku 17. Treguesit e stabilitetit financiar te subjektet tregtare me humbje




Treguesit e likuiditetit financiar mund t'i shohim në grafikun nr.19. Te subjektet tregtare me humbje në analizën e bërë në vitin 2017, nga gjithsej 40 pikë të ponderit kemi një mesatare prej 20.6 pikë ponderi, ndërsa në vitin 2016 gjithashtu kemi mesatare prej 20.6 pikë ponderi. Vetëm se ka dallim të mesatares përbrenda përbërësve të treguesve të likuiditetit. Mirëpo përsëri del një mesatare e njëjtë për vitet 2017 dhe 2016.

Grafiku 18. Treguesit e likuiditetit financiar tek subjektet tregtare me humbje



Treguesit e suksesit afarist mund t'i shohim në **Grafikun nr.20**. Te subjektet tregtare me humbje, për vitin 2017, nga gjithsej 20 pikë të ponderit, kemi një mesatare prej 2.7 pikë ponderi, kurse për v. 2016 kemi mesatare prej 2.3 pikë ponderi.

19. Treguesit e suksesit afarist te subjektet tregtare me humbje



Bazuar në **Tabelën nr.17**, sipas analizës së bërë për subjektet tregtare me humbje, për dy vitet afariste 2017 dhe 2016, kemi këtë rezultat jo shumë të mirë të bonitetit: për vitin 2017 nga 100 pikë maksimale të indikatorëve për vlerësimin e bonitetit, kemi 23.3 pikë ponderi dhe për v. 2016 kemi 22.9 pikë ponderi.

Tabela 17. Boniteti i subjekteve tregtare me humbje për vitin 2017 dhe 2016

Indikatorët për vlersimin e bonitetit	2017	Ponderi	2016
TREGUESIT E STABILITETIT FINANCIAR	0	40	0
TREGUESIT E LIKUIDITETIT FINANCIAR	20.6	40	20.6
TREGUESIT E SUKSESIT AFARIST	2.7	20	2.3
GHITHSEJ BONITETI	23.3	100	22.9

Konkluzionet dhe rekomandimet si të përmirësohet gjendja

Nga objektivat e parashtruara në këtë punim të magistraturës, mund të vijmë në disa gjetje specifike dedikuar “Bonitetit” të subjekteve afariste të zgjedhura në mostrën empirike në regjionin e Tetovës. Nga analizat e mostrës prej 65 subjekteve afariste, 17 mikro, 47 të vogla dhe 1 e mesme kemi arritur gjer në konkluzione relevante me të cilat do t’u japim përgjigje hipotezave të parashtruara dedikuar subjekteve mikro, të vogla dhe të mesme.

Boniteti i subjekteve ekonomike mikro:

Nga gjetjet e analizave të bëra mund të konstatojmë me sa vijon (shiko tabelën 18):

- Niveli i stabilitetit financiar i cenuar në vitet 2016 0-pikë dhe 37.5% ose 15 pikë në vitin 2017
- Niveli i likuiditetit financiar në nivel prej 91.75% (36.7) në vitin 2017 dhe 91% (36.4) në vitin 2016.
- Niveli i suksesit diku 89% (17.8) në vitin 2017 dhe 88,5% (17.7) në vitin 2016
- Gjithsej Boniteti në vitin 2017 me 69,5% dhe 54,1% në vitin 2016

Tabela 18. Boniteti i subjekteve ekonomike mikro

Indikatorët për vlerësimin e bonitetit	Ponderi	2017	2016
TREGUESIT E STABILITETIT FINANCIAR	40	15.0	00
TREGUESIT E LIKUIDITETIT FINANCIAR	40	36.7	36.4
TREGUESIT E SUKSESIT AFARIST	20	17.8	17.7
GHITHSEJ BONITETI	100	69.5	54.1

Verifikimi i hipotezës së parë dhe të dytë:

H₁₀: Niveli i Bonitetit i mikro subjekteve ekonomike është pozitiv!

- ✓ Nga tabela 18 konstatojmë se niveli është pozitiv i cenuar dhe **ne e pranojmë hipotezën e parë.**
- ✓ Boniteti i subjekteve mikro është pozitiv i cenuar, nga 100 pikët maksimale ne vitin 2017 kemi 69.5 pikë dhe për vitin 2016 kemi 54.1 pikë (bonitet i cenuar).

H₂₀: Trendi i nivelit i Bonitetit të mikro subjekteve ekonomike është rritës!

- ✓ Niveli i bonitetit të subjekteve mikro ka trend pozitiv, nga 54.1 pikë në vitin 2016 është rritur në 69.5 pikë në vitin 2017. Nga ky rezultat mund të **pranojmë hipotezën e dytë.**

Boniteti i subjekteve ekonomike të vogla

Nga gjetjet e analizave të bëra mund të konstatojmë me sa vijon (shiko tabelën 19):

- Niveli i stabilitetit financiar në vitet 2017 arrin 81.5% dhe në v. 2016 82.75%
- Niveli i likuiditetit financiar në nivel prej 83.5% (33.4) në vitin 2017 dhe 87.75% (35.1) në vitin 2016.
- Niveli i suksesit diku 88.5% (17.7) në vitin 2017 dhe 89% (17.8) në vitin 2016
- Gjithsej Boniteti në vitin 2017 me 83.6% dhe 86.0% në vitin 2016

Tabela 19. Boniteti i subjekteve ekonomike të vogla

Indikatorët për vlerësimin e bonitetit	Ponderi	2017	2016
TREGUESIT E STABILITETIT FINANCIAR	40	32.6	33.1
TREGUESIT E LIKUIDITETIT FINANCIAR	40	33.4	35.1
TREGUESIT E SUKSESIT AFARIST	20	17.7	17.8
GHITHSEJ BONITETI	100	83.6	86.0

Verifikimi i hipotezës së tretë dhe të katërt:

H3₀: Niveli i Bonitetit të subjekteve të vogla ekonomike është pozitiv!

- ✓ Boniteti në vitin 2017 me 83.6% dhe 86.0% në vitin 2016
- ✓ Boniteti i subjekteve të vogla është pozitiv dhe në një nivel të lartë dhe **pranohet hipoteza e tretë.**

H4₀: Trendi i nivelit i Bonitetit të subjekteve të vogla është rritës!

- ✓ Niveli i bonitetit të subjekteve të vogla ka trend rënës nga 86 pikë (2016) në 83.6 pikë (2017).
- ✓ **Hidhet hipoteza e katërt.**

Boniteti i subjekteve ekonomike të mesme

Hulumtimi i magistraturës ka limitime veçanërisht në këtë pjesë të subjekteve ekonomike pasi nga oferta e bërë ndaj 15 subjekteve të mesme, fatkeqësisht vetëm një është përgjigjur pozitivisht. Në këtë drejtim jemi të vetëdijshëm për rezultatin e cunuar që do fitojmë për këtë kategori të analizuar.

Me poshtë jepet rezultati i bonitet të analizuar për 1 subjekt ekonomik të mesëm.

Tabela 20. Boniteti i subjekteve ekonomike të mesme

Indikatorët për vlerësimin e bonitetit	Ponderi	2017	2016
TREGUESIT E STABILITETIT FINANCIAR	40	38.5	31.0
TREGUESIT E LIKUIDITETIT FINANCIAR	40	31.9	23.5
TREGUESIT E SUKSESIT AFARIST	20	17.9	9.1
GHITHSEJ BONITETI	100	88.3	63.6

H5₀: Niveli i Bonitetit të subjekteve të mesme ekonomike është më pozitiv se ato të voglat!

- ✓ Për sa i përket hipotezës numër pesë, kjo hipotezë mund të themi se pranohet vetëm për një vit, sepse te subjektet e mesme për vitin 2017 kemi 88.3 dhe për ato të vogla kemi bonitet prej 83.6 që është me pikë më të mëdha, por nëse shohim vitin 2016 tek ato të mesme kemi bonitet prej 63.6 pikë, ndërsa te subjektet e vogla kemi bonitet prej 88 pikëve.
- ✓ Hipoteza pjesërisht pranohet (rezultate të cunuar te subjektet e mesme)

H6₀: Trendi i nivelit të Bonitetit të subjekteve të mesme ekonomike është rritës!

- ✓ Hipoteza e fundit ose hipoteza numër 6 pranohet. Bazuar në tabelën numër 20 mund të shohim që kemi rritje në krahasim me vitin paraprak (analizë e cunuar vetëm për 1 subjekt).

Rekomandime

Subjekte ekonomike në regjionin e Tetovës përgjatë viteve të eksploruara 2016/2017 kanë treguar gjendje ekonomiko financiare "BONITET" në nivel të kënaqshëm. Nga përvoja ime si kontabilist i autorizuar mund të konstatoj se pjesa dërmuese e subjekteve afariste tentojnë administrativisht të realizojnë rezultate vjetore të ulëta me qëllim të reduktimit të tatimit në fitim. Si rezultat i këtij veprimi ata pa dashje e cenojnë mundësinë e realizimit të BONITETIT tejet pozitiv. Nga kjo që u tha mund të japim disa rekomandime dedikuar subjekteve të regjionit të Tetovës:

- ✓ Subjektet ekonomike duhet të nënshkruajnë kontrata të shitblerjes dhe t'i respektojnë ato.
- ✓ Subjektet ekonomike duhet respektuar afatet e shlyerjes së detyrimeve dhe nga ana tjetër realizimin e kërkesave.
- ✓ Subjektet ekonomike të kenë kujdese në Likuiditetin rrjedhës dhe atë të përgjithshëm.
- ✓ Subjektet ekonomike të mbajnë llogari në ditët e lidhjes së stoqeve të tyre.
- ✓ Subjektet ekonomike të bëhen më transparente drejt deklarimit të realizimeve dhe të evitimit të ekonomisë gri.
- ✓ Subjektet ekonomike të risin mundësinë e inkuadrimin të punonjësve formalë në punë dhe të evitojnë angazhimet informale.
- ✓ Subjektet ekonomike të luftojnë për rritjen e vlerës së organizatës duke rritur fitimet vjetore nga viti në vit, pa mos u shqetësuar për obligimet tatimore që do rrjedhin ndaj DAP-it.
- ✓ Institucionet përkatëse si Ministria e Financave-DAP si dhe Regjistri Qendror i RMV të organizojnë punëtori për të edukuar stafin e menaxhmentit të subjekteve ekonomike rreth rëndësisë së BONITETIT për subjektet e tyre si dhe zhvillimit të ekonomisë lokale dhe atë kombëtare.

Bibliografia

- [1]. Dhamo Sotiraq, (2003). Kontabiliteti financiar, Tiranë Botuesi kush është, dhe qyteti
- [2]. Dhamo Sotiraq, (2005). Kontabiliteti i avancuar, Tiranë
- [3]. Binaj Agim dhe Kallemi Flutura,(2005). Kontabiliteti botimi i pare, Tiranë
- [4]. Të ndërtojmë të ardhmen nëpërmjet kulturës financiare, Banka e Shqipërisë, 2011
- [5]. Mazllami Jeton, (2018). Ligjeratat e autorizuara “Financa për menaxher”, FBE, Seeu, Tetovë
- [6]. Zeqiri Izet, (2004). "Menaxhimi Financiar", Tetovë
- [7]. Rexhepi Sejdi, (1998). Boniteti i ndërmarrjeve në kushtet inflatore, Prishtinë
- [8]. Даскаловски Жидас, Николовска Ана, Ристеска Марија (2006). Водич за Буџет, Скопје.
- [9]. Madura Jeff, (2004). Drejtimi financiar ndërkombëtar, Melbourne-Australia
- [10]. Osmani Rufi, (2007). Kontabiliteti menaxherial botimi i parë, Tetovë
- [11]. Deari Fitim, (2007). Parimet e kontabilitetit financiar, Tetovë
- [12]. Xhafa Halit, Ciceri Beshir, (2006). Drejtimi financiar 1 botimi i tretë, Tiranë
- [13]. Xhafa Halit, Ciceri Beshir, (2006). Drejtimi financiar 2, Tiranë
- [14]. Xhafa Halit, (2005). Drejtimi financiar ndërkombëtar, Tiranë
- [15]. Karen Berman, Joe Knight, Case John, „Financial Intelligence (2006) A Manager’s Guide to Knowing what the Numbers Really Mean“, Harvard Business Press
- [16]. Block B. Stanley, Geoffrey A.Hirt, (2008). „Foundation of financial management“, McGraw-Hill, New York.
- [17]. Wiston WayneL. (2007), Microsoft Office Excel 2007 Data Analysis and Business Modeling, Microsoft Press,
- [18]. Gunter Löffler, Peter N. Posch (2007), Credit risk modeling using Excel and VBA, JohnWiley&Sons, New York
- [19]. S.Brian, Z.Thomas,(2003), Understanding of Corporate Annual Report, J Willey & Sons, New York
- [20]. Richard L. Ratliff, Wanda A. Wallace, Glenn E. Sumners, William G. McFarland, James K. Loebbecke (1996) „Internal Auditing – Principles and Technigues“, second edition, The Institute of Internal Auditors, Altamonte Springs, USA.
- [21]. Hogget and Edwards,91992). Financial Accounting in Australia, Second Edition, Australia
- [22]. Harnois Albert J, (1994). Accounting and Auditing in a New Enviroment- A guide go Personal Survival Skills and Professional Growth, AMACOM- American Management Association, USA.
- [23]. Wilkinson W. Joseph,(1991). Accounting and Information Systems, 3rd Edition, John wiley & Sons, New York.
- [24]. William F. Messier,(200). Auditing & Assurance Services, A Systematic Approach, second edition, Boston, USA.
- [25]. Robinson William,(1995). Audit Risk Assesement Approach to System Development Effords, IS Audit & Control Journal, Vol.1, Information Systems Audit and Control Association, Inc. USA.
- [26]. Slavko Vuksa (2006). Finansijsko racunovodstvo, Banja Luka,Bosnia.
- [27]. Wallace N. Davidson, McDonald James,(2014) „Guide to financial Statement Analysis, New York
- [28]. Basis for Management Advice,(2006). American Institute of certified Public Accountants, USA

- [29]. William G. Droms, Wright O.Jay,(2009). Finance and Accounting for nonfinancial managers, Anapolis, USA.
- [30]. Stephen Gilman,(2007). Analyzing financial statements, California, USA.
- [31]. Beaver Graham, Jennings Peter, (2000),“Editorial overview: small business, entrepreneurship and enterprise development”, Strategic Change, Vol. 9, Southampton, UK.
- [32]. Waldman, D.A., Yammarino Francis, (1999) “CEO charismatic leadership: levels of management and levels of analysis”, Academy of Management Review, Vol. 24, Pennsylvania, USA.
- [33]. Jean-Gustave Courcelle-Seneuil, Subjektet ekonomike 1892. Paris, France
- [34]. Erich Gutenberg, (1984) Subjektet ekonomike, Cologne, Germany.
- [35]. Kotler Philip, Armstrong Gary, Saunders John, Wong Veronica,(2010) Principle of marketing, botimi i tretë evropian, Financial Times, Illinois,USA.
- [36]. Harold Demsetz, (1995)“The economics of the business firm: Seven critical commentaries”, Cambridge University Press,California,USA.
- [37]. Hart O., Moore J.,(1990) “Property rights and the nature of the firm”, Journal of Political Economy
- [38]. Coase R.H., (1937) “The nature of the firm”, London, UK.
- [39]. Fransman Martin, (1994) “Information Knowledge, Vision and Theories of the Firm”- Industrial and Corporate Change, Edinburg,USA.
- [40]. Richard.R. Nelson, and Sidney Winter,(1982) “An Evolutionary Theory of Economic Change”, The Belknap Press, Cambridge MA,USA.
- [41]. Eurostat, *Statistics in focus*
- [42]. Charles T. Horing, Gary L. Sandem, John A. Eliot, Donna R. Filbrick, (2010) "Hyrje në Kontabilitetin Financiar", përkthimi i edicionit të nëntë, Shkup.
- [43]. Стојков Милан, (2008) "Развој на економската мисла", Скопје.
- [44]. Бојаџиески Димитар,Блажеска Олгица, (2003). Деловна економија, Економски факултет, Скопје.
- [45]. Blagoje Paunović (2009): "Ekonomika Preduzeća", Centar za ekonomsko obrazovanje, Ekonomskog fakulteta, 4 Izdanje, Beograd.
- [46]. Ligji mbi subjektet ekonomike, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë
- [47]. Ристеска Анета, (2013) Докторатурска дисертација, Влијание на малите и средните претпријатија врз економскиот развој, со посебен осврт на РМ, Прилеп.
- [48]. Дрогирска Лорета, (2012) магистерски труд “Ревизија на финансиските извештаи, Комплетирање на ревизорски процес и издавање на конечен ревизорски извештај i izdavanje na konecen revizorski izveshtaj”.
- [49]. Димитриска-Кочоска Гордана,(2011). Стопанска Банка, второ издание на "Академија на Капитал", "Капитал", Скопје.
- [50]. Мателиевска Маргарита,Паческоски Влатко, (2011). Економија на трговски друштва, Скопје.
- [51]. Николовски Пеце, (2003). Анализа и ревизија на финасиските извештаи на претпријатијата во РМ во функција на економска ефикасност” – Докторска Дисертација, Економски Факултет – Прилеп.
- [52]. Ivanis M., (2012) “Uvod u korporativne finansije i tehnike upravljanja korporativnim finansijama”, Univerzitet Singidunum Beograd,Serbia.

- [53]. Сашо Арсов, (2008) "Финансиски Менаџмент", Скопје.
- [54]. Маџова Виолета, (2010) Модели за проценка на солевнтност на банкарските клиенти, Скопје.
- [55]. Горгиева Оливера-Трајковска, (2010). Анализа на финансиски извештаи со осврт на финансиската стабилност на корпоративниот сектор во РМ. Докторски Труд, Скопје
- [56]. Stojilković Mladen, Krstić, J., (2000), Finansijska analiza. Ekonomski fakultet, Nish, Serbia.
- [57]. Radovanović Radiša, Pejić Lazar, Stanišić Milovan, (1991). Ocena boniteta proizuže, Beograd, Serbia.
- [58]. Горгиева Оливера-Трајковска, Колева Благица, (2013). Анализа на финансиски извештаи, Универзитет Гоце Делчев, Штип.
- [59]. Костадиновски Александар, (2009). Основи на финансиско сметководство, Штип.
- [60]. Knezevic Goran, (2009). Analiza Finansiskih izvestaja, Beograd, Serbia.
- [61]. Русевски Т., Недев Б., Божоновска З., Јаневски Л., Миновски З. (2004) Вовед во сметководство, Скопје.
- [62]. Службен весник на РМ БР.159, (29.12.2009). Правилник за водење на сметководство, Скопје.
- [63]. МСФИ – Рамка за изготвување и презентирање на финансиски извештаи, Скопје.
- [64]. Закон за вршење сметководствени работи 2012, Скопје
- [65]. Прирачник за изготвување на годишна сметка и финансиските извештаи, 2014 Агенд Про Агенс, Скопје.
- [66]. 200 Најголеми фирми во македонија, (2015). Еуро Бизнис Центар, Скопје
- [67]. Талеска Сузана, (2010) „Финансиско сметководство“ – Економски факултет – Прилеп.
- [68]. Трајкоски Бранкој, Трајкоска Гордана, (2001). „Финансиско работење на претприатиата“, Универзитет во Битола, Економски Факултет, Прилеп
- [69]. Кижухаров Сашо, Кочоска Маја, (2007). „Сметководство“ Трето издание, Скопје.

Ueb faqe të shfrytëzuara:

- ✓ www.kapital.com.mk
- ✓ www.slvesnik.com.mk
- ✓ www.ujp.gov.mk/
- ✓ www.crm.com.mk/DS/
- ✓ www.stat.gov.mk/
- ✓ www.ec.europa.eu
- ✓ www.finance.gov.mk
- ✓ www.kapital.com.mk
- ✓ www.eccf.ukim.edu.mk/statistika
- ✓ www.mse.mk
- ✓ www.demonstratingvalue.org/resources/financial-ratio-analysis